



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA RREGULLATORE PËR UJËSJELLËS DHE KANALIZIM
REGULATORNI URED ZA VODU I KANALIZACIJU
WATER AND WASTEWATER REGULATORY OFFICE



ZRRUK RAPORT VJETOR PUNE

2015

Mars 2016

Përmbajtja

1.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
2.	KORNIZA LIGJORE	6
3.	PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT	8
3.1.	Vizioni/Misioni	8
3.2.	Kompetencat e Zyrës Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim sipas Ligjit	9
3.3.	Organizimi i brendshëm i Zyrës Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim	9
3.3.1.	Departamenti për Ligj dhe Licenca	9
3.3.2.	Departamenti i financave dhe tarifave rregullatore	10
3.3.3.	Departamenti i Monitorimit të Performancës dhe Raportimit	10
3.3.4.	Departamenti i administratës dhe financave	10
4.	FUSHËVEPRIMI I ZYRËS RREGULLATORE PËR UJËSJELLËS	12
4.1	Organizimi i brendshëm i Zyrës Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim	14
4.2.	Ekzekutivi	155
4.3.	Burimet Njerëzore	155
4.4.	Asetet	15
5.	AKTIVITETET PËR PERIUDHEN RAPORTUESE	16
5.1.	Monitorimi i përmbushjes së caqeve (objektivave)	16
5.1.1	Përmbushja e caqeve operative - prodhimi i ujit, uji i pafaturuar, uji dhe ujërat e zeza të faturuara, numri i konsumatorëve	16
5.1.2.	Përmbushja e caqeve për shpenzimet operative për ujë dhe ujëra të zeza	17
5.1.3.	Përmbushja e caqeve të Faturimit dhe Arkëtimit	17
5.2.	Përcaktimi i tarifave për shërbimet e ujit dhe kanalizimit për vitet 2015-2017	18
5.3.	Monitorimi i performancës së ofruesve të shërbimit të ujit dhe kanalizimit	20
5.4.	Inspektimi i Ofruesve të Shërbimeve	322
5.4.1.	Shpërndarja e ngarkesave të ndërtesat e banimeve kolektive me ujëmatës të përbashkët ..	33
5.4.2.	Inspektimi për ngarkesën e konsumatorëve për dërgimin e njoftimit për shqyqje	333
5.5.	Standardet e Shërbimeve	34
5.6.	Roli dhe aktivitetet e Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve (KKK)	34
5.7.	BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET TJERA	35
5.8.	RELACIONET ME PUBLIKUN	36
6.	REKOMANDIMET	37
7.	RAPORTI FINANCIAR	38
8.	RAPORTIMI I ZYRËS SË AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM	39

AKRONIMET DHE SHKURTESAT

ZRRUK – Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim

KBPMPH – Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis e Planifikim Hapësinor

MZHE – Ministria e Zhvillimit Ekonomik

MMPH – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

MIE – Ministria e Integriteteve Evropiane

IKSHPK – Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës

NJPM – Njësia për Politika e Monitorim

TFU – Task Forca e Ujit

KRU – Kompania rajonale e Ujësjellësit

Nj.O. – Njësia Operative

KKK – Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve

TKP – treguesit Kyç të Performancës

KK – Kuvendi Komunal

AKMM – Agjencia Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit

ESK – Enti i Statistikave të Kosovës

ERRU – Enti Rregullator i Ujit (Shqipëri)

SHUKOS – Shoqata e Ujësjellësve të Kosovës

SHUKALB – Shoqata e Ujësjellës Kanalizimeve Shqipëri

IBNET – International Benchmarking Network (Rrjeti Ndërkombëtar i Benchmarkingut)

DWP – Danube Water Program (Programi i Ujërave të Danubit)

BB – Banka Botërore

BWA – Bulgarian Water Association (Shoqata e Ujërave të Bullgarisë)

PVPE – Plani i Veprimit të Partneritetit Evropian

DSPA – Dialogu i Stabilizim Asocimit

NHE – Ndërmarrje Hidro Ekonomike

NPK – Ndërmarrja Publike Komunale

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport ka për qëllim të paraqes një përmbledhje të aktiviteteve të zhvilluara dhe arritjet e ZRRUK-ut, në përmbushjen e obligimeve të përcaktuara me planin e punës në kuadër të përgjegjësiave ligjore për vitin 2015. Raporti po ashtu përmban një paraqitjen të zhvillimeve kryesore si dhe përshkruan, gjendjen aktuale të sektorit të shërbimeve publike të ujësjellësit dhe kanalizimit në Republikën e Kosovës.

Viti që lamë pas ka shënuar 11 vjetorin e themelimit të Zyrës Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim dhe pasqyron, zhvillimet pozitive si në Rregullator po ashtu edhe në sektor në përgjithësi dhe rregullimi i tij është i dukshëm në krahasim me periudhat para ekzistimit të ZRRUK-ut, megjithatë ka nevojë për angazhim dhe sforcim të përpjekjeve për zhvillim të mëtejshme me qëllim të përmirësimit të shërbimeve të cilat u ofrohen konsumatorëve.

Shërbimet publike të ujësjellësit dhe kanalizimit janë shërbime jetike për qytetarët dhe e ardhmja e ofruesve të këtyre shërbimeve varet nga eficientia e KRU-ve dhe krijimi i besimit tek konsumatorët.

Rregullimi i pavarur dhe stabil ekonomik ndikon drejtpërdrejt në përmirësimin e shërbimeve të ofruara dhe krijimin e besueshmërisë te konsumatorët, që do të thotë se edhe ne si institucion duhet përshtur të zhvillohemi me qëllim që të jemi në hap me kohën për përcaktimin dhe zbatimin e sistemit rregullator i cili mbron interesat e konsumatorëve, ndikon në nxitjen e përmirësimit të shërbimeve dhe njëkohësisht krijon lehtësimin e këtij procesi duke siguruar qëndrueshmëri afatgjate financiare për ofruesit e këtyre shërbimeve.

Duke pasur parasysh se konsumatorët nuk e kanë mundësinë e zgjedhjes së ofruesit nga i cili do të marrin shërbime të ujit dhe kanalizimit për shkak të monopolit të cilin ofruesit e këtyre shërbimeve në Kosovë e kanë, ne si Rregullator, meqenëse bëjmë licencimin e këtyre ofruesve të shërbimeve ndihemi përgjegjës për zgjedhjen të cilën e bëjmë në emër të konsumatorit.

Për këtë arsye ashtu si edhe në vitet e mëhershme, gjatë përpilimit të Planit Vjetor të punës 2016 i cili është pjesë e Planit Strategjik ZRRUK 2015 -2017, aktivitetet tona fokusohen në monitorimin e punës së ofruesve të shërbimit i cili konsiston në aspektin e zbatimit të Ligjit dhe të Rregullave në fuqi, përmbushjen e standardeve minimale të shërbimit, eficientia e mirë e ofruesve të shërbimeve të ujit dhe mbrojtja e interesit të konsumatorëve janë aktivitete kryesore në ZRRUK-ut gjatë vitit 2016 e tutje. Monitorimi i Ofruesve të shërbimeve të ujit dhe kanalizimit bëhet në dy aspekte: (i) në aspektin e përmbushjes së caqeve (objektivave) të aprovuara nga ZRRUK përmes procesit tarifor dhe (ii) në aspektin e performancës së kompanive.

Viti 2015 ka shënuar vitin e parë të periudhës së tretë tarifore tri (3) vjeçare 2015-2017. Aktiviteti i ZRRUK-ut ka qenë i orientuar në implementimin e objektivave të përcaktuar për vitin raportues si dhe rishikimin dhe rivlerësimin e përcaktimit të tarifave të viti 2016 për aplikim si pjesë e procesit afatmesëm tariforë tre vjeçar.

Shkalla e përmbushjes së caqeve (objektivave) të përcaktuara me procesin rregullator të tarifave, shkalla e realizimit të investimeve kapitale gjatë periudhës së shikuar për çdo kompani veç e veç dhe për sektorin si tërësi si dhe lëvizjet inflatore kanë qenë faktor determinues gjatë procesit të përcaktimit të tarifave për periudhën tarifore 2015 – 2017, të cilat vetëm pjesërisht kanë ndikuar kësaj radhe për përcaktim të tarifave të vitit 2016.

Gjatë këtij procesi gjithashtu rëndësi e veçantë i është kushtuar krijimit të parakushteve për qëndrueshmëri financiare të KRU-ve dhe mundësinë e pagesës së faturave nga të gjitha kategoritë e konsumatorëve.

Viti 2015 ishte viti i nëntë (9) me radhë që ZRRUK vlerëson ecurinë dhe ngecjet e ofruesve të shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit dhe shpall performancën e Kompanive të Licencuara përmes publikimit të

Raportit të Performancës i cili pritet të publikohet gjatë kuartalit të tretë të këtij viti. Informatat, analizat dhe të dhënat e këtij raporti pasqyrojnë gjendjen e këtij sektori dhe nivelin e shërbimeve që ofrohen. Ky raport mund ti ndihmojë ofruesit e shërbimeve të ujit, politikë-bërësit e sektorit por edhe vet konsumatorët për të pasur një pasqyrë reale të gjendjes së sektorit dhe nivelin e shërbimeve që ofrohen.

Uji i pa faturuar (UPF) i njour ndryshe edhe si ujë i humbur përmes rrjedhjeve, lidhjeve të paligjshme, pajisjeve matëse me të meta, ose konsumimit të paregjistruara, vazhdon të jetë një shqetësim për sektorin. Në vitin 2015, rreth 77.3 mil.m³, është uji i pa faturuar e cila sasi është reduktuar për 2% në krahasim me vitin paraprak 2014.

Gjate tri viteve të para të kësaj periudhe vlersuse, shitjet sasore të ujit nuk kanë shënuar përmirësim, perkundrazi ka pasur një trendë të përkeqësimit. Por, është ngrit sasia e ujit të faturuar gjatë vitit 2015 në krahasim me vitin 2014 për 4.0 mil.m³.

Shkalla e arkëtimit në raport me faturimin në nivel të sektorit në vitin 2015 ishte 74% apo 1%, më e ulët se në vitin 2014, përderisa krahasuar me vitin 2012 shkalla e arkëtimit shumë pak është përmirësuar dhe atë vetëm 3%. Efiçenca e arkëtimit në nivelin 74%. është nivel shumë i ulët dhe jo i kënaqshëm, meqenëse ende mbi 1/4 e borxheve nga konsumatorët, mbetet pa u inkasuar.

Përmbushja e Standardeve Minimale të Shërbimit nga ana e ofruesve të shërbimeve është obligative dhe njëkohësisht është edhe mjeti më efikas i cili siguron promovimin dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve. Prandaj edhe përcjellja e përmbushjes së këtyre Standardeve përmes inspektimeve të vazhdueshme në terren dhe monitorimit të raporteve të cilat ofruesit e shërbimeve i paraqesin në ZRRUK, sikurse në vitet paraprake edhe gjatë vitit 2015 ka qenë ndër aktivitetet kryesore të punës sonë. Me qëllim të nxitjes së konsumatorëve për vendosjen e ujëmatësve, edhe gjatë vitit 2015 ka vazhduar të jetë në fuqi Vendimi për faturim paushall sipas procedurave Interne të aprovuara nga ZRRUK.

Kualiteti i ujit të pijës është i rregulluar dhe monitorohet nga IKSHPK, në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 16/2012, i cili është në përputhje me direktivën e BE për ujin e pijshëm. ZRRUK, ka vazhduar edhe në vitin 2015, të bëjë analizen e kualitetit të ujit duke u bazuar në të dhënat e raportuara nga IKSHPK. Në vitin 2015 rreth 97.5%, e mostrave të analizuar si në aspektin bakterologjik dhe fiziko-kimik, kanë qenë në përputhje me standardet e kërkuar.

Në nivel sektori orët mesatare të furnizimit me ujë kanë shënuar një rritje të lehtë nga 21 në 22 orë për 2015, Reduktimet e ujit të cilat kane zgjatur për një periudhë të gjatë, ka vazhduar të jetë më pakë të theksuar në KRU (Prishtina, Mitrovica si dhe Bifurkacioni). Kompanitë të cilat arrin të furnizojnë konsumatorët e tyre 24 orë me ujë të pijshëm janë: KRU (Hidrodrini, Radoniqi dhe Hidromorava), edhe pse problem me furnizim të rregulltë në këto tri kompani kanë qenë herë pas here gjatë sezonit të verës.

Sikur gjatë vitit 2015 edhe në të ardhmen, ZRRUK me të njëjtin përkushtim do të kontribuojë në rritjen e profesionalizmit, transparencës, bashkëpunimit ndërinstitutional brenda dhe jashtë vendit në mënyrë që me autoritetin e tij rregullator të krijojë ekuilibrin e duhur mes ofruesve të shërbimit, politikë-bërësve dhe konsumatorit.

Shpresoj se informacionet dhe rekomandimet e këtij Raporti do të jenë të dobishme për të gjitha palët e interesit të cilët janë të përfshirë në zhvillimin e politikave të sektorit të ujit në Kosovë.

Në fund falënderojmë stafin e ZRRUK dhe bashkëpunëtorët e këtij sektori për kontributin e dhënë gjatë vitit të kaluar. Progresi dhe arritjet në të ardhmen janë më të lehta kur ekziston bazë paraprake dhe arritjet e vitit 2015. janë bazë e qëndrueshme për të vazhduar edhe më tej përmirësimin e këtij sektori.

Me respekt

2. KORNIZA LIGJORE

Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim (ZRRUK) është organ i pavarur rregullator i cili bën licencimin dhe rregullimin ekonomik të ofruesve të shërbimeve të Ujësjellësit, Kanalizimit dhe të furnizimit të ujit të përpunuar dhe të papërpunuar me pakicë dhe shumicë në Kosovë

ZRRUK është themeluar më 26 nëntor të vitit 2004 me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/49 në pajtim me Kornizën Kushtetuese të Kosovës. Rregullorja 2004/49 është amendamentuar me Ligjin Nr. 03/L-086 “Ligji për Ndryshimin e Rregullores 2004/49 mbi Aktivitetet e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjellësit, Kanalizimit dhe Mbeturinave” të aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më datë 13 qershor 2008, me ç’rast raportimi i ZRRUK-ut nga UNMIK-u ka kaluar te Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit për Mbeturina (Nr. 04/L-060) më 08 qershor 2012, përgjegjësitë dhe kompetencat e sektorit të mbeturinave janë bartur te Qeveria e Kosovës dhe Pushteti Lokal, pra që nga miratimi i këtij Ligji ZRRUK nuk është përgjegjës për rregullimin e veprimtarive të Ofruesve të shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave.

Duke u nisur nga ky fakt ZRRUK ka marrë iniciativë për të propozuar iniciimin e procedurave për amendamentimin e Ligjit Nr. 03/L-086 i cili ka kaluar procedurat e rregullta dhe me 5 Janar 2016 Ligji i ri nr. 05/L-042 është aprovuar dhe dekretuar dhe si i tillë është obligativ për tu zbatuar.

2.1. BAZA EKZISTUESE LIGJORE E FUNKSIONIMIT TË ZRRUK-UT:

- Rregullorja e UNMIK-ut 2004/49
- Ligji nr. 03/L-086 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2004/49 për veprimtaritë e ofruesve të shërbimeve të ujësjellësit kanalizimit dhe mbeturinave, dhe
- Ligji i ri nr. 05/L-042

Sipas autorizimeve të dhëna nga kjo bazë ligjore dhe legjislacionit tjetër që ka të bëjë me sektorin e ujit, ZRRUK, ka nxjerr 8 Rregulla në Janar të vitit 2005, me të cilat në mënyrë të hollësishme ka përcaktuar mënyrën e rregullimit të fushave të veçanta për të cilat ky institucion është përgjegjës.

Në vijim janë listuar Rregullat e nxjerra nga ZRRUK me të cilat rregullohet shërbimi publik i ujit;

- Rregulla për Licencimin e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjellësit, Kanalizimit dhe Furnizimit të Ujit me Shumicë në Kosovë,
- Rregulla për Përcaktim të Tarifave të Shërbimit për Shërbimet e Ujësjellësit, Kanalizimit dhe të Furnizimit të Ujit me Shumicë në Kosovë,
- Rregulla për Standardet Minimale të Shërbimit të Ofruesve të Shërbimeve të Ujit në Kosovë,
- Rregulla për Kartën e Konsumatorëve për Ofruesit e Shërbimeve të Ujit në Kosovë,
- Rregulla për Shkyçje e Shërbimeve të Ujit nga Ofruesit e Shërbimeve të Ujit në Kosovë,
- Rregulla për Faljen dhe Rregullimin e Borxheve të Vjetra nga Ofruesit e Shërbimeve të Ujit dhe Kanalizimit në Kosovë,
- Rregulla për Amnistinë e Kyçjeve të Paligjshme në Shërbimet Publike të Ujit nga Ofruesit e Shërbimeve të Ujit dhe Kanalizimit në Kosovë,
- Rregulla për Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimit në Kosovë.

2.2. Përmirësimi i bazës ligjore:

Varësisht nga vlerësimet dhe nevojat e paraqitura nga palët e interesit (ZRRUK, ofruesit e shërbimeve, konsumatorët etj) aktet nën ligjore të nxjerra nga ZRRUK duhet të rishqyrtohet dhe duhet tu përshtaten ndryshimeve të bëra në ligj gjatë këtij viti raportues.

2.2.1. Amandamentimet:

Gjatë periudhës raportuese (vitit 2015) janë krye këto aktivitete si;

- (i) Amendamentim Rregullës për Kartën e Konsumatorëve për Ofruesit e Shërbimeve të Ujit në Kosovë (R04);
- (ii) Shqyrtimin Rregullës për Standarde Minimale të Shërbimit të Ofruesve të Shërbimit të Ujit në Kosovë (R03) si aktivitet rutinor i DL&L dhe ZRRUK. Këtij aktiviteti i është përgjigjur vetëm KRU"Prishtina" propozimet e së cilës janë vlerësuar si jo praktike, jo profesionale.

Ajo që vlen të theksohet edhe ky aktivitet nuk ka mundur të finalizohet nga arsyet e cekura në hyrje të këtij Raport.

2.2.2. Vendimet

Në mungese të drejtorit dhe Zëvendës Drejtorit të ZRRUK-ut, gjatë vitit 2015 nuk është marr asnjë vendim.

3. PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT

Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim (ZRRUK) është rregullator i pavarur ekonomik për shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit në Kosovë dhe i përgjigjet Kuvendit të Republikës së Kosovës. Roli i ZRRUK- është që të sigurojë ofrimin e shërbimeve cilësore, efikente, të sigurta dhe në baza jo-diskriminuese për të gjithë konsumatorët në Kosovë, duke pasur parasysh mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit publik. Me aktivitetet e veta të përditshme, përmes bashkëpunimeve me Rregullatorët e rajonit dhe institucioneve tjera relevante, si dhe përmes projekteve mbështetëse, ZRRUK angazhohet të adaptojë praktikën më të mira Evropiane për rregullimin ekonomik të ofruesve të shërbimeve. Përveç sigurimit të shërbimeve kualitative ZRRUK, ka parasysh gjithmonë që çmimet e këtyre shërbimeve të jenë të përballueshme për konsumatorët duke mos lënë pas edhe qëndrueshmërinë financiare të ofruesve të shërbimeve.

3.1. VIZIONI/MISIONI

Vizioni:

Shërbime cilësore, të sigurta dhe efikente të ujësjellësit dhe ujërave të zeza për të gjithë konsumatorët në Kosovë

Misioni:

Rregullimi i shërbimeve të ujit në mënyrë efektive dhe transparente në pajtim me praktikën e mira Evropiane të cilat sigurojnë që ofruesit e shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit të japin shërbime kualitative, të qëndrueshme dhe me çmime të përballueshme në tërë Kosovën, duke pasur parasysh ruajtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit Publik.

3.2. KOMPETENCAT E ZYRËS RREGULLATORE PËR UJËSJELLËS DHE KANALIZIM SIPAS LIGJIT

Kompetencat dhe përgjegjësitë kryesore të Zyrës Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim janë:

- Licencimi i ndërmarrjeve publike të cilat ofrojnë shërbime të ujësjellësit e kanalizimit dhe furnizimin e ujit me shumicë në Kosovë,
- Përcaktimi i tarifave të cilat krijojnë parakushte për qëndrueshmëri financiare të ofruesve të shërbimeve të ujit, merr parasysh mundësinë e pagesës së faturave nga të gjitha grupimet e konsumatorëve për shërbimet e marra, si dhe ka në konsideratë rrethanat socio-ekonomike në vend,
- Përcaktimi i standardeve të shërbimeve të ofruara dhe monitorimi i zbatueshmërisë së tyre,
- Mbrojtja e interesave të konsumatorëve - duke pasur parasysh se ofruesit e shërbimeve nuk i nënshtrohen kushteve të tregut, ZRRUK përmes aktiviteteve të veta siguron që ofruesit e shërbimeve mos ta keqpërdorin monopolin të cilin e kanë në këtë lloj të shërbimit, duke garantuar se shërbimet e ofruara janë në pajtim me standardet e përcaktuara të shërbimit,
- Monitorimi dhe raportimi i performancës së ofruesve të shërbimeve me qëllim të nxitjes së konkurrencës përmes krahasimit ("benchmarking"), duke synuar përmirësimin e performancës së tyre,
- Monitorimi i përmbushjes së e caqeve të cilat përcaktohen dhe aprovohen nga ZRRUK përmes procesit tarifar,
- Përcaktimi i obligimeve dhe të drejtave të ndërsjella për ofruesit e shërbimeve dhe konsumatorëve si dhe monitorimi i zbatueshmërisë së tyre,
- Themelimi dhe përkrahja e Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve si një mekanizëm për të hulumtuar dhe zgjidhur ankesat e Konsumatorëve, analizuara shërbimet e ofruara, këshilluar dhe rekomanduar Rregullatorin për vendim marrje etj.

3.3. ORGANIZIMI I BRENDSHËM I ZYRËS RREGULLATORE PËR UJËSJELLËS DHE KANALIZIM

Përmbushja e kompetencave të cekura më lart dhe detyrave tjera të përcaktuara me Ligj, bëhet përmes departamenteve të ZRRUK. Secili nga departamentet ka obligimet e veta specifike dhe në këtë mënyrë mundësohet që ZRRUK si institucion të sigurojë zbatimin e akteve rregullative. Në vijim janë paraqitur departamentet dhe përgjegjësitë e tyre kryesore:

3.3.1. Departamenti për Ligj dhe Licenca

- Amendamenti dhe mbikëqyrja e zbatimit të legjislacionit primar dhe sekondar,
- Licencimi i Kompanive Publike që ofrojnë shërbime të ujësjellësit e kanalizimit dhe të furnizimit të ujit me shumicë
- Mbikëqyrja e zbatimit të kushteve të përcaktuara me licencë të shërbimit
- Inspektimi për të vlerësuar shkallen e plotësimit të standardeve të shërbimit
- Inicimi i procedurave për sanksione dhe masa ndëshkuese administrative në rast të mospërmbushjes së standardeve
- Mbrojtja e interesave të konsumatorëve përmes implementimit të Rregullës për kartën e konsumatorëve dhe nëpërmes të Komisioneve këshilluese të Konsumatorëve të themeluara në 7 regjionet në të cilat veprojnë ofruesit e shërbimeve të ujit
- Mbështetje ligjore për të gjithë stafin e ZRRUK në lidhje me aktivitetet e përditshme rregullatore.

3.3.2. Departamenti i financave dhe tarifave rregullatore

- Përcaktimi i tarifave për ofruesit e licencuar të shërbimeve të furnizimit me ujë me pakicë dhe shumicë, trajtimin dhe shkarkimin e ujërave të zeza.
- Përpilimi dhe nxjerrja e urdhëresave tarifore të shërbimit për ofruesit e licencuar të shërbimeve
- Monitorimi i përmbushjes së e caqeve të cilat përcaktohen dhe aprovohen nga ZRRUK përmes procesit tarifar.
- Mbledhja e të dhënave, përpunimi, analiza dhe vlerësimi i tyre, si dhe përpilimi e pasqyrave të ndryshme dhe Raporteve periodike dhe vjetore në të cilat pasqyrohet shkalla e arritshmerisë dhe trendët zhvillimore të nivelit të shërbimeve dhe efektet ndikuese të tarifave të kompanitë dhe konsumatorët.
- Draftimin, asistimin dhe nxjerrjen e akteve të ndryshme legislative për rregullativën ekonomike të shërbimeve publike të ujit.
- Rishikimi i akteve tjera rregullative mbështetëse për aspektet rregullatore të tarifave etj.

3.3.3. Departamenti i Monitorimit të Performancës dhe Raportimit

Është njëri prej tre Departamenteve funksionale të ZRRUK, i ngarkuar me përgjegjësin për të bërë, Monitorimin dhe raportimin i performancës së ofruesve të shërbimeve. Procesi i monitorimit i udhëhequr nga ZRRUK, fokusohet në fushat siç janë; shërbimi ndaj konsumatorëve, kostot operative dhe kapitale, si dhe aspektet e tjera financiare dhe operative të punës së ofruesve të shërbimeve. Rregullatori mbledhë të dhëna dhe informata, (raportet mujore, dhe vjetore me të dhëna, sipas formatit dhe afateve të përcaktuara nga Rregullatori), Ky mekanizim rregullator ka për qëllim nxitjen e konkurrencës, përmes krahasimit (“benchmarking”) duke synuar përmirësimin e performancës së tyre.

DMP&R, në vazhdimësi bënë monitorimin e shërbimeve të ofruara nga ofruesit e shërbimeve të cilat duhet të jenë në pajtueshmëri me standardet e shërbimit të përcaktuar pas verifikimit dhe në vazhdimësi, raporton nivelet e shërbimeve të arritura gjatë periudhave të shikuara, duke publikuara raporte periodike dhe vjetore të performancës, në të cilin shpaloset në hollësi vlerësimi i performancës së arritur, në mënyrë që të:

- Sigurojë funksionimin eficient të ofruesve të shërbimeve, dhe sektorit,
- Përcaktoj nivelin në të cilin ofruesit e shërbimeve i përmbushin objektivat e përcaktuara përmes procesit tarifar dhe standardet e shërbimeve.
- Identifikojë veprimet korrigjuese që mund të jenë të nevojshme për të përmirësuar gjendjen etj.

Këto janë mekanizmat e përdoruar nga ZRRUK, për të sfiduar operatorët shërbimeve të ujit për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve në secilën nga këto fusha. Në bëmë monitorimin e performancës së kompanive për t'u siguruar që ato tu përgjigjen pozitivisht sfidave, duke i vlerësuar se në ç'mas kanë arrit objektivat e cilësisë së shërbimeve ndaj konsumatorëve që janë akorduar me proceset rregullatore.

3.3.4. Departamenti i Administratës dhe Financave

Ky departament është i angazhuar për;

- Organizimin dhe funksionimin e administratës dhe financave të brendshme të ZRRUK
- Hartimi dhe zbatimi i politikave zhvillimore në fushën e administratës; planifikimi, hartimi, raportimi, mbikëqyrja dhe menaxhimi i buxhetit, financave dhe prokurimeve të ZRRUK

- Zbatimi i ligjeve dhe rregulloreve në aspektin e administrimit të buxhetit, financave, dhe prokurimit
- Zbatimi i ligjeve, rregulloreve dhe urdhëresave administrative për shërbyesit civil
- Planifikimi, mbikëqyrja dhe administrimi i pajisjeve teknologjike dhe pasurisë së ZRRUK
- Ofrimi i shërbimeve logjistike

4. FUSHËVEPRIMI I ZYRËS RREGULLATORE PËR UJËSJELLËS

Fushëveprimi i Zyrës Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim përfshin ndërmarrjet publike të cilat ofrojnë shërbime të ujësjellësit, kanalizimit dhe furnizimit të ujit me shumicë.

Në vijim janë paraqitur ndërmarrjet e Licencuara nga ZRRUK të cilat ofrojnë shërbime të ujësjellësit, kanalizimit dhe furnizimit të ujit me shumicë të cilat veprojnë në Kosovë, rregullimin ekonomik të të cilave e bën ZRRUK.

Ripërtëritja e Licencave për këto Kompani është bërë nga ZRRUK me datën 01.11.2012 në pajtim me kornizën ligjore të përcaktuar me Ligjin Nr. 03/L-086 si dhe me procedurat dhe rregullat e përcaktuara me legjislacionin sekondar në kohëzgjatje prej 3 (tri) vitesh, gjegjësisht deri me 31.10.2015.

(i) Kompanitë e Licencuara për Shërbimet e Ujësjellësit dhe Kanalizimit

1. **KRU “Prishtina” Sh. A. Prishtinë**, ofron shërbime në komunat: Prishtinë, Fushë Kosovë, Obiliq, Podujevë, Lipjan, Shtime dhe Drenas
2. **KRU “Hidroregjioni Jugor” Sh. A. Prizren**, ofron shërbime në komunat: Prizren, Malishevë, Suharekë Dragash dhe Mamushë;
3. **KRU “Hidrodriini” Sh. A. Pejë**, ofron shërbime në komunat: Pejë, Istog, Klinë, Junik dhe Deçan
4. **KRU “Mitrovica” Sh. A. Mitrovicë**, ofron shërbime në komunat: Mitrovicë, Skenderaj dhe Vushtrri
5. **KRU “Radoniqi” Sh. A. Gjakovë**, ofron shërbime në komunat: Gjakovë, Rahovec dhe Prizren
6. **KRU “Hidromorava” Sh. A. Gjiilan**, ofron shërbime në komunat: Gjiilan, Kamenicë dhe Viti
7. **KRU “Bifurkacioni” Sh. A. Ferizaj**, ofron shërbime në komunat: Ferizaj dhe Kaçanik.

Ndërmarrjet publike të ujësjellësit dhe kanalizimit që kanë ekzistuar në komunat me popullatë shumicë serbe (Shtërpçë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan) kanë mbetur jashtë proceseve të ristrukturimit dhe korporatizimit dhe rrjedhimisht kanë mbetur jashtë procesit rregullator të cilin aktualisht e zbaton ZRRUK.


(ii) Kompania e Licencuar për Furnizim të Ujit me Shumicë

Kompania e vetme e licencuar që ofron ujë me shumicë është:

1. **“Ibër-Lepenci” Sh. A.** e cila furnizon ujë me shumicë për KRU “Mitrovica” Sh. A. Mitrovicë dhe për KRU “Prishtina” Sh. A. Prishtinë.


Në përputhje me aktet rregullative në fuqi, furnizimi i ujit me shumicë është përkufizuar si furnizim i ujit të papërpunuar për ofruesit e shërbimeve të ujit dhe ujërave të zeza.

Zonat e Shërbimeve të Kompanive të Ujësjellësit dhe Kanalizimit



4.1 ORGANIZIMI I BRENDSHËM I ZYRËS RREGULLATORE PËR UJËSJELLËS DHE KANALIZIM

ZRRUK aktivitetet e veta i përmbush sipas organizimit të paraqitur në organogram:



4.2. EKZEKUTIVI

Në bazë të Ligjit 03/L086 dhe Ligjit të ri nr. 05/L-042 dhe në bazë të organizimit të brendshëm, ekzekutivi i ZRRUK përbëhet nga Drejtori, Zëvendës Drejtori dhe Kryesuesit e Departamenteve.

- Drejtori dhe Zëvendës Drejtori emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me mandat pesë vjeçar,
- Kryesuesit e Departamenteve zgjidhen me konkurs, Kryesuesit e Departamenteve kanë mandat të përhershëm,
- Drejtorit dhe Zëvendës Drejtorit u ka kaluar mandati ligjorë me 15 Prill 2015 dhe që nga ajo kohë ZRRUK funksionon pa Drejtorin dhe Zëvendës Drejtorin.

4.3. BURIMET NJERËZORE

- Numri i të punësuarve në ZRRUK është 19 veta.
- Me qëllim të ngritjes profesionale, si çdo vit edhe gjatë vitit 2015 ishte përgatitur plani vjetor i trajnimeve për periudhën Janar 2015 – Dhjetor 2015 për të punësuarit e ZRRUK.

Tabela nr. 1 Trajnimet e planifikuara për vitin 2015.

Nr	Nevojat për trajnim	Numri i të unësuarve që duhen trajnuar
1	Word dhe Excel ECDL	15
2	Administrim i dokumenteve	17
3	Gjuhe angleze	17
4	Hartim i dokumenteve zyrtare (vendime, kontrata, raporte etj)	17
5	Menaxhim i burimeve njerëzore	2
6	Menaxhim i Aseteve	1
7	Prokurim	1

IKAP gjatë vitit 2015 nuk ka organizuar asnjë trajnim sipas kërkesave tona dhe mbetet të shikohet mundësia të organizohen trajnimet e tilla nga vet rregullatori.

4.4. ASETET

Duke pasur parasysh ligjet e zbatueshme në Kosovë mbi themelimin e institucioneve të Kosovës, Buxhetin e Konsoliduar të Republikës së Kosovës si dhe Rregulloret e Thesarit, institucionet buxhetore vetë e bëjnë regjistrimin e asetëve ndërsa amortizimin e tyre mbi vlerën 1000€ e bën departamenti i Thesarit.

Vlera e asetëve të përgjithshme pas regjistrimit dhe vlerësimit për vitin 2015 në ZRRUK është 15,275.13€.

- Asetet e ZRRUK janë mjetet e punës përmes të cilave i përmbushim obligimet tona. Në këto mjete bëjnë pjesë; 5 vetura, kompjuterë, laptopë, printerë, fotokopje, server, tavolina, karrige,
- Sipas planifikimeve për dy vitet e ardhshme nuk kemi nevojë për asete të reja, mjafton mirëmbajtja e tyre.

ZRRUK është me seli në Bregun e Diellit, Rr. “Ferat Dragaj”, nr. 68 – Prishtinë. Hapësira fizike në të cilën jemi të vendosur përfshin gjithsej 518 m²:

- hapësira e objektit (zyre) - 428m²
- parking - 60m²
- garazhe - 30m²
- Për hapësirë të cilën e shfrytëzon ZRRUK paguan qira.

5. AKTIVITETET PËR PERIUDHEN RAPORTUESE

ZRRUK ka obligim ligjor dhe detyrë që përmes aktiviteteve të veta dhe autoritetit të dhënë me ligj të sigurojë se ofruesit e licencuar të shërbimeve të ujit zbatojnë Ligjin dhe Rregullat në fuqi me qëllim të ofrimit cilësorë të shërbimeve, sigurimit të konsumatorëve se marrin shërbime adekuate dhe mbrojtjen e tyre, transparencës në punë dhe stimulimin e konkurrencës mes tyre. Përbushja e këtyre obligimeve edhe gjatë vitit 2015 është arritur përmes aktiviteteve dhe detyrave të parapara në Planin Strategjik dhe në Planin Vjetor të Punës.

Gjatë periudhës raportuese janë realizuar aktivitetet në vijim;

1. Rishqyrtimi i rregullat i procesit të rivlerësimit të tarifave të vitit 2016, bazuar në të dhënat e aprovuara, dhe realizuar gjatë vitit 2015. Tarifat e vitit 2015 janë vazhduar për aplikim edhe gjatë vitit 2016,
2. Monitorimi dhe raportim i përbushjes së caqeve gjatë vitit 2015 me tri raporte periodike,
3. Mbështetja e Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve në aspektin profesional dhe konsultat rreth rezultateve të vitit 2015 dhe tarifave të vitit 2016.
4. Përmbjllja e procesit të raportimit të KRU-ve ndaj ZRRUK-ut, përpilimi i raporteve periodike dhe vjetore me vlerësimin e përbushjes së caqeve dhe me performancën e shërbimeve publike të ujit.
5. Shqyrtimi i aplikacioneve për ri-përtrirjen e licencave të KRU-ve,
6. Inspektimi në teren dhe tek KRU-të me qëllim të verifikimit të aktiviteteve të tyre për përbushjen e standardeve të shërbimit etj.

5.1. MONITORIMI I PËRMBUSHJES SË CAQEVE (OBJEKTIVAVE) NGA ANA E KRU

Përmes këtij aktiviteti monitorohet përbushja e caqeve të cilat përcaktohen dhe aprovohen nga ZRRUK përmes procesit tarifar. Përbushja apo mospërbushja e caqeve është një ndër faktorët determinues për përcaktimin e tarifave të vitit pasues.

Procedurat e monitorimit kryhen nga analizimi i të dhënave për përbushje apo mospërbushje të caqeve të aprovuara të disa prej treguesve kryesor – tregues të cilët janë të njëjtë për analizimin e të gjitha kompanive.

Të dhënat sigurohen nga raportimet në baza mujore dhe raportet vjetore të KRU-ve në ZRRUK, të cilat llogariten të jenë sakta dhe plotësisht të vlefshme pasi të ketë përfunduar procesi i analizimit dhe auditimit nga stafi profesional i rregullatorit.

Të dhënat e shfrytëzuara për analizën e përbushjes së caqeve dhe analizën e performancës për vitin 2015 janë të dhëna të pa audituara (megjithatë pasqyrat financiare ende nuk janë përmbyllur) ndërsa të dhënat e vitit 2014 janë të verifikuara me procesin e auditimit të vitit 2014.

Të dhënat e vitit 2015 do të saktësohen pas përmbylljes së fazës së auditimit.

Në vijim përmes tabelave dhe shpjegimeve është paraqitur shkalla e përbushjes së caqeve të aprovuara nga ZRRUK të disa prej treguesve kryesor në nivel të sektorit nga ofruesit e shërbimeve gjatë vitit 2015.

Ndër treguesit kryesor të cilët përcaktojnë dhe japin një pasqyrë më të qartë janë të dhënat operative dhe financiare.

5.1.1 Përbushja e caqeve operative - prodhimi i ujit, uji i pafaturuar, uji dhe ujërat e zeza të faturuara, numri i konsumatorëve

Për analizë të dhënave operative janë marrë parasysh të dhënat sasiore për metër kub (m³): (I) uji i prodhuar, (II) uji i humbur apo i pa faturuar, (III) uji i faturuar, (IV) ujërat e zeza të faturuara; (V) numri i konsumatorëve.

Të dhënat janë paraqitur në formë tabelore të sistemuara në 7 kolona ku janë pasqyruar të dhënat e vitit 2014 për krahasim me të dhënat e aprovuara dhe realizuar nga KRU-të për periudhën e shikuar.

Tabela Nr. 2. Pasqyra e të dhënave sasiore për ujin e prodhuar, ujin e humbur, ujin e faturuar dhe numrin e konsumatorëve të shërbyer gjatë vitit 2014, krahasuar me të dhënat e caceve të përcaktuara, aprovuara dhe realizuara të vitit 2015 dhe me % krahasuese dhe me vlerësimin e ZRRUK-ut për shkallën e përbushjes së objektivave të vitit 2015.

Te dhënat për shërbimet e sektorit të ujit	Njësia matëse	Realizuar për 2014	Aprovuar për vitin 2015	Realizuar për vitin 2015	Ndryshimi ne % (5/4*100)	Vlerësimi
1	2	3	4	5	6	7
Uji i prodhuar	m ³	131,828,167	137,647,526	137,036,232	100%	R
Uji i humbur	m ³	74,739,456	68,320,416	77,269,436	113%	Jo e R
Uji i faturuar	m ³	57,088,711	69,327,111	59,766,796	86%	Jo e R
Konsumatorët	Nr	286,985	290,262	297,857	103%	R

Sqarimi i shkurtësive për vlerësimin: Jo e R = Jo e realizuar- vlerësim negativ, R = Realizuar-vlerësim pozitiv

- sasia e ujit të aprovuar si humbje nga sasia e ujit të aprovuar si cak për prodhim 49.64%.
- sasia e ujit të realizuar si humbje nga sasia e ujit të prodhuar 56.39%,
- sasia e ujit të faturuar nga sasia e ujit të aprovuar si cak 50.37%, dhe
- sasia e ujit të faturuar nga sasia e ujit të prodhuar nga KRU-të 43,62%.

Siç edhe është paraqitur në tabelën Nr. 2, sasia e ujit të prodhuar dhe ajo e faturuar nuk janë realizuar dhe performanca e tyre vlerësohet negativisht, ndërsa sasia e ujit të humbur dhe numri i konsumatorëve kanë trend pozitiv të realizimit dhe si të tilla vlerësohen pozitivisht.

5.1.2. Përbushja e caceve për shpenzimet operative për ujë dhe ujëra të zeza

Në këtë grup në formë tabelore (tabela Nr. 3) janë paraqitur të dhënat për shpenzimet operative, duke paraqitur kostot paraprake të shërbimeve të ujit për vitin 2014 dhe ato të aprovuara dhe realizuar gjatë të njëjtës periudhë kohore të vitit 2015, të cilat na mundësojnë krahasimin e këtyre të dhënave dhe vlerësimin e shkallës së përbushjes së objektivave të përcaktuara për vitin 2015.

Tabela Nr. 3. Pasqyra e të dhënave të shpenzimeve operative gjatë vitit 2014 të krahasuara me të dhënat e vitit 2015, me caqet e aprovuara dhe realizuara të vitit 2015, krahasimi në % i të dhënave të aprovuara dhe realizuara të vitit 2015 me vlerësimin e ZRRUK-ut për shkallën e përbushjes së objektivave të periudhës së shikuar.

Te dhënat për shërbimet e sektorit të ujit	Njësia monet.	Σ e shpenzimeve për vitin 2014	Σ e aprovuar nga ZRRUK 2015	Σ e realizuar nga KRU-të 2015	% e realizim. të cakt. për vitin 2015	Vlerësimi
Shuma e Shpenzimeve operative sektoriale	€	21,280,697	21,178,370	21,821,008	103%	(N) Negativ

5.1.3. Përbushja e caceve të Faturimit dhe Arkëtimit

Në tabelën e më poshtme janë pasqyruar të dhënat sektoriale për faturim dhe arkëtim për vitin paraprak 2014, sikurse që janë pasqyruar edhe të dhënat e aprovuara dhe realizuara nga sektori për periudhën e shikuar të vitit 2015, përqindja krahasuese dhe vlerësimi i përbushjes së objektivave.

Tabela Nr. 4. Pasqyra e të dhënave të faturimit dhe arkëtimit gjatë vitit 2014 të krahasuara me të dhënat e vitit 2015, caqet e aprovuara dhe të realizuara të vitit 2015, krahasueshmi në % i të dhënave të aprovuara dhe realizuara për vitin 2015 me vlerësimin e ZRRUK-ut për shkallën e përmbushjes së objektivave të periudhës së shikuar.

Te dhënat për shërbimet e sektorit të ujit	Njësia monit.	Σ e faturimit dhe arkëtimit për vitin 2014	Σ e faturimit dhe arkëtimit të aprovuar për vitin 2015	Σ e faturimit dhe arkëtimit të realizuar për vitin 2015	% e faturimit dhe arkëtimit për vitin 2015	Vlerësimi
Shuma e faturimit	€	28,384,605	34,943,972	30,640,125	88%	Jo e R (Negativ)
Shuma e arkëtimit	€	20,978,444	26,190,686	22,563,675	86%	Jo e R (Negativ)

Përveç KRU “Radoniqi” sh. a. Gjakovë e cila ka tejkaluar si e vetëme shkallën e arkëtimit për 5.28% (por jo edhe të faturimit) të vitit 2015, asnjë nga KRU-të tjera në vend nuk kanë arritur përmbushjen e objektivave të përcaktuara për faturim dhe arkëtim gjatë vitit biznesorë të shikuar. Përforma e sektorit në përgjithësi vlerësohet jo e arritur dhe jo efikiente për vitin 2015.

5.2. PËRCAKTIMI I TARIFAVE PËR SHËRBIMET E UJIT DHE KANALIZIMIT PËR VITET 2015-2017

Në vitin raportues 2015, sipas obligimeve rregullatore të procesit rregullator të tarifave të periudhës tarifore 2015-2017 fillimisht është përcaktuar tarifa për aplikim për vitin 2015, me të drejtë rishikimi të rregullt dhe të jashtëzakonshme.

Bazat e rishikimit të tarifave për faturim të konsumatorëve janë; shkalla e përmbushjes së caqeve të përcaktuara me proces rregullator të tarifave, shkalla e realizimit të investimeve kapitale gjatë periudhës së shikuar për çdo kompani veç e veç dhe për sektorin si tërësi, lëvizjet inflatore dhe gjendja socio-ekonomike në vend.

Lëvizjet inflatore dhe gjendja socio ekonomike në vend do të monitorohen nga publikimet e bëra të Agjencisë së Statistikave të Kosovës përgjatë periudhave të caktuara raportuese të cilat i publikon Agjencioni.

Tarifat volumetrike të shërbimeve të furnizimit me ujë në nivel të sektorit gjatë vitit 2015 ishin ngrit për nga 0.01 €/m³ në krahasim me tarifat e vitit 2014 për të dy grupimet e konsumatorëve (shtëpiakë dhe jo-shtëpiakë) për 5 ofrues të shërbimeve nga 7 ofrues sa kanë aplikuar për rishikim të tarifave të periudhës tarifore 2015-2017 dhe të njëjtat janë vazhduar për aplikim edhe gjatë vitit 2016, bazuar në faktin se ZRRUK ka vepruar pa menaxhment të lartë ekzekutiv i cili si organ vendim marrës në rregullatorë është autoritet i vetëm për vendim marrje të tilla.

Tarifat për vitin 2016 nga procesi rregullator i tarifave afatmesme të periudhës 2015 - 2017 janë përcaktuar nga të dhënat e Biznes Planeve Rregullatore të aprovuara nga ZRRUK dhe të realizuara nga ofruesit e shërbimeve, treguesve tjerë, lëvizjeve inflatore dhe gjendjes socio-ekonomike në vend dhe për këto arsye ZRRUK ka marr vendim tu vazhdohet vlefshmëria e tarifave të vitit 2015 edhe gjatë vitit 2016. Gjatë vitit 2015 nuk ka pas ndonjë fluktuim i lëvizjeve inflatore në krahasim me vitin paraprak.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur tarifat volumetrike të shërbimeve publike për furnizim me ujë dhe ato të shërbimeve të ujërave të zeza të aplikuara gjatë periudhës së përmbyllur tarifore 2012-2014, ato për aplikim gjatë vitit 2015 dhe 2016 dhe tarifat e planifikuara me mundësi rishikimi për periudhën rregullatore të tarifave të viteve 2016-2017, për çdo ofrues të shërbimeve veç e veç dhe tarifat mesatare të sektorit në nivel të vendit.

Tabela Nr. 5. Tarifat komulative volumetrike për shërbimet e ujit për të dy grupimet e konsumatorëve (Vlerat tarifore të pasqyruara, janë pa TVSH)

Kompania	Grupimi i konsumatorëve	Njësia matëse	Tarifat finale 2012	Tarifat finale 2013	Tarifat finale 2014	Tarifat 2015	Tarifat 2016	Tarifat 2017	Ndryshimi në valutë €/m ³ për vitet 2015-2017 në krahasim me vitin 2014		
KRU Prishtina	Shtëpiak	€/m ³	0.42	0.43	0.43	0.44	0.44	0.45	0.01	0.01	0.02
	Jo-shtëpiak	€/m ³	0.98	0.98	0.98	0.99	0.99	0.99	0.01	0.01	0.01
KRU Hidroregjioni	Shtëpiak	€/m ³	0.36	0.40	0.41	0.42	0.42	0.42	0.01	0.01	0.01
	Jo-shtëpiak	€/m ³	0.70	0.78	0.79	0.80	0.80	0.80	0.01	0.01	0.01
KRU Hidrodrini	Shtëpiak	€/m ³	0.28	0.29	0.29	0.30	0.30	0.30	0.01	0.01	0.01
	Jo-shtëpiak	€/m ³	0.55	0.60	0.60	0.61	0.61	0.61	0.01	0.01	0.01
KRU Mitrovica	Shtëpiak	€/m ³	0.41	0.45	0.45	0.45	0.45	0.45	0.00	0.00	0.00
	Jo-shtëpiak	€/m ³	0.93	0.96	0.96	0.96	0.96	0.96	0.00	0.00	0.00
KRU Radoniqi	Shtëpiak	€/m ³	0.40	0.43	0.44	0.45	0.45	0.45	0.01	0.01	0.01
	Jo-shtëpiak	€/m ³	0.88	0.91	0.92	0.93	0.93	0.93	0.01	0.01	0.01
KRU Bifurkacioni	Shtëpiak	€/m ³	0.44	0.45	0.45	0.46	0.46	0.46	0.01	0.01	0.01
	Jo-shtëpiak	€/m ³	0.98	0.97	0.97	0.98	0.98	0.98	0.01	0.01	0.01
KRU Hidromorava	Shtëpiak	€/m ³	0.40	0.41	0.41	0.41	0.41	0.41	0.00	0.00	0.00
	Jo-shtëpiak	€/m ³	0.90	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85	0.00	0.00	0.00
SEKTORI	Shtëpiak	€/m ³	0.39	0.41	0.41	0.42	0.42	0.42	0.01	0.01	0.01
	Jo-shtëpiak	€/m ³	0.85	0.86	0.87	0.88	0.88	0.88	0.01	0.01	0.01

Në vijim janë pasqyruar edhe të dhënat sektoriale krahasuese të tarifave volumetrike në Kosovë me tarifat volumetrike të disa qendrave në regjion tonë.

Tabela Nr. 6. Tarifat volumetrike të vendeve të Regjionit

Nr	Shteti	Qyteti	Konsumatorët	Tarifa volumetrike për ujë dhe kanalizim €/m ³
1	Kosovë	Mesatarja	Shtëpiak	0.42
			Jo shtëpiak	0.88
2	Shqipëri	Tiranë	Shtëpiak	0.40
			Jo shtëpiak	1.07
2	Shqipëri	Durrës	Shtëpiak	0.66
			Jo shtëpiak	1.18
3	Maqedoni	Shkup	Shtëpiak	0.48
			Jo shtëpiak	1.07
4	Mali i Zi	Herceg Novi	Shtëpiak	1.05
			Jo shtëpiak	2.16
5	Serbi	Novi Sad	Shtëpiak	0.67
			Jo shtëpiak	1.58
6	Bosnja dhe Hercegovina	Sarajevë	Shtëpiak	0.51
			Jo shtëpiak	1.59
7	Kroacia	Osijek	Shtëpiak	1.47
			Jo shtëpiak	2.11

5.3. MONITORIMI I PERFORMANCËS SË SEKTORIT DHE KOMPANIVE RAJONALE TË UJËSJELLËSIT(KRU)

Struktura e shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimeve konsiderohet të jetë ajo e një monopoli natyror, prandaj në mungesë të konkurrencës në treg. ZRRUK, përmes rregullimit ekonomik angazhohet të caktojë parakushtet për mos shfrytëzim të përparësive të tilla të cilat ky shërbim i ka, duke përcaktuar kriteret e rregullimit të shërbimit me të cilat krijohen parakushtet për qëndrueshmëri financiare dhe vazhdimësi të shërbimeve nga kompanitë e licencuara nga ZRRUK dhe të përcaktojë tarifa të ekuilibruar të cilat janë të përballueshme për pagesë të faturave që konsumatorët i marrin për shërbimet e ofruara. Një metodë për ta bërë këtë të tillë është parimi i krahasimit, ku performanca e ofruesve të ndryshme mund të matet kundër njëri-tjetrit sipas standardeve të përcaktuara vendore. Globalisht konkurrenca krahasuese(Benchmarking) ka provuar se nxit konkurrencën midis operatoreve të shërbimeve publike të ujit i motivon kompanitë për të përmirësuar performancën e tyre, si dhe të bëj performanca më mire se kompanitë tjera simotra. Të dhënat e shërbyera për analizën e vitit 2015, janë bazuar në të dhëna ende të pa audituara, pasi që pasqyrat financiare të KRU-ve derisa jemi duke e përpiluar këtë raport, nuk janë përmbyllur, ndërsa të dhënat për vitin 2012, 2013 dhe 2014, janë të dhëna të audituara nga proceset e kaluara audituese.

- Mbulueshmëria me shërbime të Ujësjellësit dhe Kanalizimit

Paraqete raportin e popullsisë vendore me qasja të sigurt dhe të besueshëm në shërbime të ujësjellësit dhe kanalizimit të ofruar nga KRU-të.




Fig.1 Mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit dhe kanalizimit

Në fig.1, janë dhënë trendët e progresit të mbulueshmëris me shërbime të ujësjellësit dhe kanalizimit, përgjatë katër viteve të fundit(2012-2015).

Treguesi i mbulueshmëris me shërbime ujësjellësit u rrit nga 78% në vitin 2012 në 86% në vitin 2015, që dmth. një normë rritje prej 8%.

Treguesi i mbulueshmëris me shërbime të kanalizimit po ashtu ka shënuar trendë graduale të përmirësimit vit pas viti. Përderisa në vitin 2012, niveli i mbulueshmëris me kanalizim ishte 56%, në vitin 2015, ka arritur në nivelin 65%.

Ky tregues mbetet ende nën nivelin e pranueshme, prandaj, ka nevojë për më shumë fokus në kanalizim për të reduktuar pasojat e tij të pafavorshme. Niveli i ultë i shërbimit të kanalizime përbën një sfidë serioze për shëndetin publik dhe në mënyrë të konsiderueshme i kontribuon përkeqësimit të cilësisë së burimeve ujore.

- **Prodhimi i ujit, shitjet dhe uji i pa faturuar**

Fig. 2, pasqyron vëllimin e ujit të trajtuar dhe për të shpërndarë në një rrjet, përndryshe në këtë figurë shifrat e humbjeve të ujit mundë të shikohen në raport me shifrat prodhimit të ujit.




Fig.2, Vlerat sasiore te prodhimit të ujit, shitjeve dhe UPF-së

Pas dy viteve (2013-2014) të reduktimit të prodhimit të ujit, kryesisht për shkak të thatësisë e cila ka mbretëruar në vende, tani në vitin 2015, pothuajse sasia e ujit të prodhuar ka arritur atë të nivelit të vitit 2012. Në raport me vitin 2014, sasia e ujit të prodhuar në vitin 2015, ka qene për 6.2 mil. m³, më e lart.

Kjo rritje e prodhimit e ndodhur kryesisht tek KRU 'Mitrovica' sh. a. Mitrovicë, dhe KRU 'Prishtina' sh. a. Prishtinë, ka qene e nevojshme për të përmirësuar orët e furnizimit, në zonën e shërbimit të këtyre dy kompanive.

KRU-të, duhet të synojë reduktimin e UPF-ës, para se të vendosin për rritjen e prodhimit. Me efikasitet të mirë operative, një rritje të prodhimit të ujit duhet të jenë të nevojshme vetëm me një rritje të bazës së konsumatorëve dhe /ose për të përmirësuar orët e furnizimit.

Uji i pa faturuar i humbur: përmes rrjedhjeve, lidhje të paligjshme, pajisjeve matëse me të meta ose konsumimit të paregjistruara, vazhdon të jetë një shqetësim për sektorin. Në vitin 2015, rreth 77.3 mil. m³, është uji i pa faturuar duke shënuar humbjen e të ardhurave dhe rritje të shpenzime operative dhe kapitale.

Gjatë tri viteve të para të kësaj periudhe vlerësuese 2012-2014, shitjet sasiore të ujit nuk kanë shënuar përmirësim, përkundrazi ka pasur një trend të përkeqësimit. Është e evidente se në vitin 2015 është shënuar përmirësim. Nga totali i prodhimit prej 137 mil. m³, rreth 59.8 mil. m³, janë faturuar (shitur). Kjo është për rreth 4.0 mil. m³, uji i shitur me tepër nga të gjitha KRU-të gjatë vitit 2015 në krahasim me shitjet e ujit të regjistruara gjatë vitit 2014.

- **Efiçenca e Faturimit (Qarkullimi)¹ dhe Arkëtimit**

Tabela, në vijim paraqet performancën e shitjeve në nivel të sektorit, gjatë 4 viteve të fundit. Në përgjithësi KRU, janë duke përmirësuar efiçencën e faturimit dhe të arkëtimit vit pas viti, si në vlerë monetare ashtu edhe në përqindje (%).

¹ Qarkullimi ka përfshirë të hyrat nga faturimi i rregullt për shërbimet e ujit dhe të kanalizimit, si dhe të hyrat nga aktivitete të tjera operative, 2 Keshi, përfshinë arkëtimin nga faturimi i rregullt për shërbimet e ujit dhe të kanalizimit si dhe të hyrat nga aktivitete të tjera operative.

Tab. 7, Vlerat monetare te Qarkullimi(faturimit) dhe arkëtimit

Vitet	Qarkullimi €	Arkëtimi/keshi €	Keshi/Qarkullimin
2012	28,607,199	20,252,725	71%
2013	29,587,835	21,134,228	71%
2014	29,296,793	21,890,723	75%
2015	31,593,489	23,517,038	74%




Fig. 3, Shumat monetare për faturimi dhe arkëtimi aktual

Efiçenca e Qarkullimit, në vlerë monetare në nivel sektori gjatë vitit 2015/2014, ka shënuar një përmirësim, dhe atë për 2,986,290€ apo shprehur në përqindje për 10%, po ashtu edhe Efiçenca e arkëtimit, është përmirësuar në vlerë monetare për 3,264,313.42€, apo shprehur në përqindje për 16% po gjatë kësaj periudhe.

Efiçenca e arkëtimit në raport me qarkullimin(faturimin) në nivel të sektorit në vitin 2015 ishte e 74% apo 1%, më e ulët se në vitin 2014, përderisa krahasuar me vitin 2012, shkalla e arkëtimit shumë pak është përmirësuar, vetëm 3%.

Efiçenca e arkëtimit në raport me Qarkullimin në vitin 2015, ka arritur nivelin 74%. Ky është nivel shumë i ulët dhe jo i kënaqshëm, meqenëse ende mbi 1/4 e borxheve nga konsumatorët, mbetet pa u inkasuar.

• Investimet Kapitale

Në vazhdimësi KRU-të, kanë paraparë provizionime të konsiderueshme përmes, proceseve tarifore për shpenzime kapitale për ujë dhe ujëra të zeza.

Për vitin 2015, projeksionet kapin vlerat rreth 46.5 mil.€, të parapara të sigurohen si nga mjetet vetanake ashtu edhe nga donacionet. Fatkeqësisht, shpenzimet e realizuara për këtë qellim në vitin 2015, nga të gjitha KRU ishin shumë të ulëta. Në përgjithësi të gjitha KRU-të gjatë vitit 2015, janë realizuar vetëm 8% e investimeve kapitale nga shuma e planifikuar. Ekziston mundësia që investimet e realizuar nuk janë pasqyruar akoma në librat financiare të kompanive dhe kjo mund të ndryshohet.

Tab.8, Shumat financiare (planifikuara dhe realizuara) për investime në shërbimet e ujësjellësit dhe ujërave të zeza-2015

KRU	Planifikimi	Realizimi	%
Investimet kapitale për shërbimet e furnizimit me ujësjellës dhe ujëra të zeza(KRU)	5,8mil. €	1,6 mil. €	29%
Investimet kapitale për shërbimet e furnizimit me ujësjellës dhe ujëra të zeza(GRANTE)	40,6mil. €	2,0mil. €	5%
Totali i Investimeve Kapitale	46,4 mil. €	3,6mil. €	8%

Nga fig. 4, në të cilën janë paraqitur vlerat e investimeve, përgjatë viteve 2012-2015, shohim se ato, janë në rënje të vazhdueshme. Është evidente se shumica e investimeve, janë nga donacionet, përderisa me pak investime kanë bërë kompanitë nga të hyrat vetanake.




Fig. 4, Vlerat e realizuar për investimeve kapitale(2012-2015)

Shpresojmë se një progres, do të ndodhë në të ardhmen nëse KRU-të jenë më të përkushtuara në zbatimin e projeksioneve të tyre të shpenzimeve investive ashtu siç janë të paraqitura dhe aprovuara nga Rregullatori në biznes planet e tyre.

PERFORMANCA INDIVIDUALE E KRU

Janë 7 KRU të rregulluara të sektorët e shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimeve. Aktualisht janë rreth 1.8 million njerëz që jetojnë në zonën e shërbimit të KRU-ve, ku 1.5 milion prej tyre, marrin shërbimet e ujit në mënyrë të sigurtë dhe të besueshme.

Përderisa disa nga treguesit në këtë raport janë të bazuara në Standardet minimale të shërbimit të cilat, janë pjesë e kushteve të licencës. Treguesit shtesë operativ dhe financiar, kanë qenë të përfshira për të siguruar lexuesit me një kuptim më të gjerë të performancës së KRU-ve.

Vlerësimi i performancës bazohet në 11 treguesit kryesor të performancës, siç janë: Mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit dhe kanalizimit, Cilësia e ujit, Vazhdimësia e furnizimit me ujësjellës, Matja e ujit, Efikasiteti i stafit, Uji i pafaturuar, Efienca e arkëtimit, Norma e mbulimit të punës, Shpenzimet për njësi të furnizimit me ujë, Kostot dhe struktura e shpenzimeve operative.

ZRRUK, raporton për performancën e këtyre kompanive të ujit çdo vit, duke përdorur informacionet e raportuara prej tyre për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor vit pas viti. Në kuadër të obligimit ligjorë që kemi edhe për vitin 2015 përgatit këtë raport pune për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

- **Mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit**

Mbulueshmëria me shërbime të furnizimit me ujë, e definuar si përqindja e popullsisë brenda zonës së shërbimit me qasje në shërbime të sigurt dhe të besueshëm të furnizimit me ujë nëpërmjet lidhjeve në rrjetin publik të furnizimit.

Vlerësimi i mbulueshmerisë me shërbime, ka marrë për bazë të dhënat nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës i dalë nga regjistrimi i fundit i vitit 2011 për ekonomitë familjare si dhe në bazë të numrit aktual të raportuar nga KRU-të për kategorinë e konsumatorëve aktiv të amvisërisë.




Fig. 5, Mbulueshmëria me shërbimet e ujësjellësit

Mesatarja në nivel sektori ka shënuar rritje të lehtë nga 84% në 86% në vitin 2015 në raport me vitin 2014. Vetëm katër KRU kanë mbulueshmëri të pranueshme mbi mesataren e sektorit prej 86%.

Nivel i lartë i mbulueshmërisë në KRU 'Prishtina', para së gjithash, duket te jetë për shkak të lëvizjes² së banorëve nga zonat që nuk janë në zonë e shërbimit të saj. Në aspektin gjeografik të shtrirjes së shërbimeve kryesisht në zonat rurale, KRU 'Prishtina' sh. a. Prishtinë, ka ende hapësirë për rritjen e mbulueshmëris me shërbime.

Shkallën e mbulueshmërisë më të ulët dhe atë dukshëm nën mesataren e sektorit me shërbimet e ujësjellësit vazhdojnë ta kenë KRU-të (Mitrovica, Hidroregjioni Jugor dhe Hidromorava).

- Mbulueshmëria me shërbime të ujërave të zeza(kanalizimi)**

Mbulueshmëria me shërbime të kanalizimit është e definuar si përqindja e popullsisë, brenda zonës së shërbimit që kanë shërbim të kanalizimit.




Fig. 6, Mbulueshmëria me shërbimet të kanalizimit

Mbulueshmëria me shërbime të ujërave të zeza në nivel sektori sikurse edhe tek shërbimi i furnizimit me ujë ka shënuar progres të lehtë për të arritur në nivelin 65%, në vitin 2015.

² Fluksi i madhë i lëvizjes së banorëve nga pjesët e tjera të vendit dhe mos regjistrimi i tyre si ekonomi, përkundrazi regjistrimi si konsumatorë të KRU 'Prishtina'

Janë shumica e KRU-ve të cilat kanë mbulueshmëri me shërbime të kanalizimit rreth 50%, sidomos është brengosëse gjendja në KRU ‘Hidrodrini’ sh. a. Pejë, e cila vazhdon të këtë hapësirë të konsiderueshme për përmirësim.

KRU ‘Prishtina’ dhe ‘Bifurkacion’, janë dy nga gjithsej shtatë KRU-të, me një nivel të pranueshëm të mbulimit me shërbime të kanalizimit, e para me mbi 89% dhe e dyta me 80%.

• Cilësia e ujit

Cilësia e ujit është një tregues shumë e rëndësishme për shkak të ndikimit që ka në shëndetin e konsumatorëve. Niveli i pajtueshmërisë me cilësinë e ujit, merr parasysh numrin total të mostrave të analizuar në raport me totalin e mostrave (rezultateve) që plotësojnë, vlerat parametrike të standardeve vendore. Për rastin tonë konkrete, është e rëndësishme të theksohet se kemi një përputhshmëri të ulët, dmth. mungesë në respektimin e standardeve të cilësisë.




Fig. 7, Cilësia e ujit

Kualiteti i ujit të pijes është i rregulluar dhe monitorohet nga IKSHPK, në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 16/2012, i cili është në përputhje me direktivën e BE-së, për ujin e pijshëm. ZRRUK, ka vazhduar edhe në vitin 2015, të bëjë analizën e kualitetit të ujit duke u bazuar në të dhënat e raportuara nga IKSHPK-ja.

Në total kanë qene 7555, mostra të analizuar prej të cilave në 5446 janë bere testime bakteriologjike, përderisa pjesa tjetër prej 2109, kanë qenë testime fiziko-kimik, në total 7365 apo përqindja e mostrave prej 97.5%, kanë qenë në përputhje me standardet e kërkuar.

Brengosëse, vazhdon të jete niveli i kualitetit të ujit në aspektin fiziko-kimik e sidomos aspekti bakteror në KRU ‘Hidrodrini’ sh. a. Pejë. Sa i përket pajtueshmërisë së testeve mikrobiologjike 8%, ka qene norma e pa pajtueshmërisë me vlerat parametrike të standardeve vendore në 2015. Dështime të mëdha bakteriologjike, kanë ndodhur gati në të gjitha komunat ku kjo kompani ofron shërbime.

Performance të mirë në kualitetin e ujit të pijshëm të distribuuar tek konsumatorët e tyre në vitin 2015, kanë treguar KRU-të (“Radoniqi”, “Prishtina” dhe “Hidromorava”).

• Vazhdimësia e furnizimit me ujësjellës

Orët mesatare të furnizimit është një tregues standard i performancës i cili pasqyron informacion se sa orë në ditë një konsumatorë, ka mundësi të marrë ujë të pijshëm nga sistemi i furnizimit me ujë gjatë ditës. Ky tregues ka të bëjë me ndërprerjet e planifikuar³, të Ujit dhe përshkruan kohëzgjatjen mesatare të furnizimit me ujë në lidhjen e konsumatorit, është specifik për një zonë të shërbimit të një KRU.

³ Reduktime të vazhdueshme të ujit për një periudhë më të gjatë kohore për shkak të mungesës së kapaciteteve furnizuese.




Fig. 8, Vazhdimësia e furnizimit me ujë të pijes

Kryesisht ka qenë mungesa e kapaciteteve të mjaftueshme prodhuese si dhe norma e lartë e humbjeve të ujit, dy faktorët kyç të cilat kanë ndikuar që shumica e KRU-ve, mos të jenë në mundësi të ofrojnë në vazhdimësi të pandërprerë furnizim me ujë.

Fig. 8, tregon gamën e orëve të furnizimit me shërbime të ujësjellësit në ditë nga KRU. Në nivel sektori orët mesatare të furnizimit me ujë kanë shënuar një rritje të lehtë nga 21 në 22 orë për 2015. Ky progres i furnizimit me ujë të pijshëm, ka ardh si rezultat i furnizimit më të mire nga KRU (Prishtina dhe Mitrovica).

Reduktimet e ujit të cilat kane zgjatur për një periudhë të gjatë, ka vazhduar të jetë më pakë e theksuar në KRU (Prishtina, Mitrovica si dhe Bifurkacioni). KRU-të, të cilat arrin të furnizojnë konsumatorët e tyre 24 orë me ujë të pijshëm janë” KRU ‘Hidrodrini’, ‘Radoniqi’ dhe ‘Hidromorava’, edhe pse probleme me furnizim të rregullt këto tri kompani kanë herë pas here gjatë sezonit të verës.

• Matja e ujit

Çdo konsumatorë ka të drejtë për një ujëmatës për të siguruar që ata të paguajnë, saktë për ujë që konsumojnë. Kjo është përgjegjësia e ofruesve të shërbimeve për të siguruar që ujëmatësit janë funksional, të mirëmbajtur rregullisht dhe se faturat, janë lëshuar për konsumatorët, sipas leximit të ujëmatësit. Nga ana tjetër, kur uji i konsumuar matet, konsumatorët në përgjithësi bëhen më të kujdesshëm me përdorimin e tij. Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës, paraqet normën e konsumatorëve të cilët janë pajisur me ujëmatës në raport me totalin e konsumatorëve aktiv të shërbyer.




Fig. 9, Proporcioni konsumatorëve me ujëmatës

Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës në nivel sektori në vitin 2015, nuk ka pasuar ndonjë përmirësim ka mbetur në nivel të njëjtë prej 93%, sikurse në vitin paraprak 2014. Treguesi i mbulueshmeris me ujëmatës, është dukshëm nën normën e kërkuar ligjore prej 100%.

KRU 'Mitrovica' sh. a. Mitrovicë, ende ka një nivel të ultë të matjes 66%, edhe pse raporti i matjes është përmirësuar për 2% (nga 64% në 66%), përmirësimi vit pas viti, tek kjo kompani është shumë gradual.

- **Efikasiteti i stafit**

Tregon numrin e punonjësve (stafit) të rregullt i angazhuar në shërbime të ujësjellësit dhe të kanalizimit, për të ju shërbyer 1000 konsumatorëve. Kjo nënkupton se norma më e ulët, tregon efikasitet më të madhe të stafit në KRU.




Fig. 10, Norma e efikasitetit të stafit

Në vitin 2015 në raport me vitin 2014, efikasiteti i stafit në nivel të sektorit është përmirësuar, duke rënë në normën 6.24, rezultat i të cilës ka qenë rritja e numrit të konsumatorëve (6.4%), edhe përkundër ngritjes së numrit të punëtorëve.

Shumica e KRU-ve, në vend, janë në nivelin e akceptueshem të efikasitetit të stafit. Kjo dmth. se ndodhen, në nivel më të ultë se 8 punëtorë⁴, për 1000 konsumatorë të shërbyer.

KRU 'Prishtina' sh. a. Prishtinë, është kompania me performancën më të mirë në efikasitetin e stafit, përderisa performancë më të dobët ka treguar KRU 'Mitrovica' sh. a. Mitrovica. Ndonëse efikasiteti i ulët i stafit në KRU 'Mitrovica', kryesisht është ndikuar nga situata e imponuar për të furnizuar me një sasi të ujit të prodhuar dhe dërguar në pjesën veriore të Mitrovicës⁵.

- **Uji i pa-faturuar**

Uji i Pa Faturuar (UPF), është një masë e ujit të humbur në sistemin e shpërndarjes. Kjo pra, është diferenca në mes të sasisë së ujit të trajtuar të shpërndarë në rrjetë dhe sasisë së ujit të faturuar. UPF-ja përbëhet nga humbjet teknike (rrjedhjet) dhe humbjet komerciale (lidhjet e paligjshme, konsumatorët e pa faturuar, humbjet në ujëmatësit e konsumatorëve, etj).

Humbjet e ujit (rrjedhja), është një çështje e rëndësishme për konsumatorët dhe mjedisin. Për më tepër reduktimi i humbjeve të ujit nuk është vetëm ekonomikisht e justifikueshme (reduktimin e kostove operative dhe shpenzimeve kapitale), por edhe kontribuon që ofruesit e shërbimeve të mos përmbushin, detyrimet e tyre ndaj konsumatorëve për furnizim të qëndrueshëm.

⁴ Standard i pranueshem ndërkombëtar

⁵ Rreth 25%, e ujit nga totali i prodhimit vjetor në KRU 'Mitrovica', dërgohet tek pjesa veriore e Mitrovicës, si uji i trajtuar me shumicë.




Fig. 11, Uji të Pa-faturuar(UPF)

Sido që të jetë UPF-ja, mbetet një sfidë e madhe në këtë sektor dhe për të gjitha KRU-të, pa përjashtim. Niveli i ujit të pa-faturuar në mesatare të sektorit, në raport me ujin e prodhuar dhe distribuuar tek konsumatorët, shprehur në përqindje gjatë vitit 2015 është në nivelin 56%, kjo është me e përmirësuar për 2 %, në raport me vitin 2014, kur ajo ishte 58%.

Në 2015, disa KRU përfshirë: Radoniqin, Bifurkacionin, Hidroregjionin jugor si dhe Hidrodrini, kanë shënuar progres sa i përket reduktimi të UPF. Përkundër këtij progresi, në KRU (Mitrovica, Prishtina dhe Hidromorava) janë shënuar rritje të UPF-së në vitin 2015.

Kompania me nivelin më të lartë të UPF, edhe me tej mbetet KRU 'Hidrodrini' sh. a. Pejë, ndonëse në vitin 2015, ka shënuar reduktim të dukshëm të UPF-së, për normën 5%. Kjo e arritur është si rezultat i menaxhimit më të mirë të prodhimit të ujit si dhe rritjes sasiore të shitjeve të ujit.

- Efienca e arketimit Shkalla e arkëtimit**

Efikasiteti i arkëtimit është përqindja e mbledhure shumëve të faturuara për shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit gjatë vitit. Ky është njëri prej treguesve me domethënës i cili krahas efijencës së faturimit dhe reduktimit të humbjeve të ujit, ka impakte të drejtpërdrejta në qëndrueshmërinë financiare të kompanisë.




Fig. 12, Shkalla e arkëtimit

Shkalla e arkëtimit për faturat e shërbimit të ujit dhe të kanalizimit si mesatare e sektorit për vitin 2015, nuk ka ndryshuar nga viti paraprak që d.m.th, ka mbet e njëjtë në nivelin 74%.

Në vitin 2015, progresin më të mirë krahasuar me vitin 2014, në shkallën e arkëtimit e ka arritur KRU 'Mitrovica' sh. a. Mitrovicë, me një ngritje prej 8%, edhe pse në raport me kompanitë e tjera prapë mbetet kompania me performancën më të dobët.

Objektivat e përcaktuara me proceset rregullatore (tarifore) për vitin 2015, nuk kanë mundur të arrihen në shumicën e kompanive. Përderisa në nivel të sektorit, devijimi është vetëm prej 1% nga 75% e planifikuar, përjashtuar KRU (Radoniqi, Hidromorava dhe Hidrodrini), të cilat në vitin 2015, kanë arritur planifikimet.

Tab 9. Shkalla e arkëtimit sipas kategorive të konsumatorëve dhe totali për vitet 2014-2015

Kategoria e konsumatorëve	Prishtina		Hidroregjioni Jugor		Hidrodrini		Mitrovica		Radoniqi		Bifurkacioni		Hidromorava	
	2014	2015	2014	2015	2014	2015	2014	2015	2014	2015	2014	2015	2014	2015
Amvisëri	71%	67%	71%	73%	62%	69%	39%	47%	78%	83%	62%	63%	68%	78%
kom.-industrial	96%	86%	56%	63%	75%	79%	118%	76%	81%	71%	56%	73%	88%	81%
Institucione	95%	99%	122%	98%	80%	83%	53%	89%	147%	116%	102%	41%	83%	79%
Totali	80%	76%	75%	74%	68%	73%	48%	56%	83%	83%	64%	63%	72%	79%

Në Tab. 3, jep një pasqyrë të shkallës së arkëtimit për vitet 2014 dhe 2015, të ndarë për kategori të konsumatorëve. Ende sfide, mbetet përmirësimi i normës së arkëtimit tek kategoria e konsumatorëve të amvisërisë, edhe pse edhe efienca në dy kategoritë, biznese dhe institucione lënë shumë për të dëshiruar.

Në KRU 'Mitrovica', konsumatorët e amvisërisë, janë paguesit më të dobët të borxheve, vetëm 47% të tyre, arrijnë ti shlyejnë borxhin për shërbimin e ofruar nga ofruesi i tyre i shërbimeve.

Dështimi i KRU-ve, për të mbledhur të ardhurat e tyre ka çuar në probleme të rrjedhës së parasë duke rezultuar në rritjen e llogarive të arketueshme, duke reflektuar pastaj në mungesë të mjeteve për investime kapitale.

- **Norma e mbulimit të punës**

Norma e mbulimit të punës është treguesi i gjendjes së qëndrueshmërisë dhe performancës financiare të KRU-ve. Ky tregues pasqyron atë sa KRU-të, kanë qenë në gjendje ti mbulojnë shpenzimet operative me të hyrat e arkëtuara.




Fig. 13. Norma e mbulimit të punës

Norma e mbulimit të punës në nivel të sektorit, ka treguar tendencë të ngritjes krahasuar me vitin 2014 nga 1.03 në 1.08, që do të thotë se sektori është duke u përmirësuar financiarisht, kjo ka mundësuar mbulimin e shpenzimeve operative nga të hyrat vetanake. Kjo është mbi normën dëshiruar prej 1.0. Megjithatë, ka ende nevojë që Ofruesit e shërbimeve të administrojnë, masat e kontrollit, sidomos tek reduktimi i kostove dhe rritjen e efikasitetit të arkëtimit për t'u mundësuar që më shpejt të lëvizin drejt arritjes së mëtejshme të qëndrueshmërisë operative.

Përmirësimin me të lartë në vitin 2015, krahasuar me vitin 2014 e ka arritur KRU 'Hidromorava' sh. a. Gjilan, si rezultat i ngritjes së e hyrave nga faturimi i rregullt dhe të hyrave operative.

KRU 'Mitrovica', ende qëndron me performancë të paqëndrueshme financiare duke sjell mungesë në ofrimin e shërbimeve të dobëta për konsumatorët e saj.

Në përgjithësi norma e mbulimit të punës është rritur, në KRU 'Radoniqi', 'Prishtina', 'Hidrodrini', si dhe në 'Bifurkacioni', ndërsa norma e mbulimit të punës ka shënuar rënje në KRU 'Hidroregjioni Jugor' dhe 'Mitrovica'.

- **Shpenzimet për njësi e furnizimit me ujë**

Kostoja e operimit është një çështje shumë kritike në ofrimin e shërbimeve. Shpenzimet e operimit, kryesisht lidhen me shpenzimet e personelit, të energjisë, mirëmbajtjen, kemikaljeve si dhe shpenzimet administrative, këto kanë një ndikim të madhe në efikasitetin e një kompanie. Këto janë analizuar nga ZRRUK, gjatë procesit të aprovimit të tarifave dhe janë rregulluar në mënyrë që të parandalojë që shpenzimet e pajustifikuara të kalojnë të konsumatorët.

Shpenzimet për njësi e furnizimit me ujë




Fig. 14, Shpenzimet njësi për furnizim me Ujë

Në vitin 2015 në nivel të sektorit, kostoja për njësi e furnizimit me ujë ka qenë 0.37 EUR/m³, dhe është e me e lart për 0.02 EUR/m³, krahasuar me vitin paraprak.

KRU 'Prishtina', 'Bifurkacioni', 'Hidroregjioni-Jugor' dhe KRU 'Mitrovica', në vitin 2015, kanë treguar trende pozitive, kryesisht për shkakun e rënies së shpenzimeve operative totale për shërbimet e ujit, përkundër rritjes së volumit të ujit të shitur.

KRU 'Prishtina', edhe këtë vit mbetet me koston më të lartë të furnizimit me ujë me 0.40 EUR/m³, mirëpo në krahasim me vitin paraprak është përmirësuar dukshëm.

KRU 'Hidrodrini', këtë vit prin me performancën më të mirë, por me një ngritje nga 0.20 EUR/m³ në 0.22 EUR/m³, rezultat i të cilës ka qenë ngritja e shpenzimeve operative të ujit për 5%.

- **Kostot dhe struktura e shpenzimeve operative**

Kontrollimi i kostove operative është shumë kritike në ofrimin e shërbimeve. Shpenzimet e mëdha për paga dhe energji të cilat në vitin 2015, për KRU përfshijnë 84%, (nga totali i shpenzimeve), kanë ndikuar esencialisht në efikasitetin e KRU. Efektivisht shpenzimet operative, janë analizuar gjatë rregullimeve në procesin e tarifave të vendosura nga ZRRUK, në mënyrë për të parandaluar që shpenzimet e pajustificuara të kalojnë tek konsumatorët.

ZRRUK, parimisht nuk i ka sfiduar kostot të caktuara tek disa kategori, të tilla si kimikalet, meqenëse ka konsideruar se, një reduktim i mundshëm i tyre mund të mos jetë domosdoshmërishtë i dëshirueshëm, pasi kjo mund të nënkuptojë një kompromis në cilësinë e ujit. Shpenzimet për këtë kategori, janë të ultë dhe atë(1%).




Fig. 15. Proporcioni i kategorive të shpenzimeve operative për sektorin

Normën më të lartë në strukturën e shpenzimeve operative tek kompanitë e ujit e përbëjnë shpenzimet për stafin (pagat) dhe atë për 61%, e cila krahasuar me vitin paraprak 2014, ka pasur rritje prej 2%, duke tejkaluar njëkohësisht edhe ato të planifikuara për 5%.

KRU 'Radoniqi' dhe 'Bifurkacioni', kanë shpenzimet më të larta për staf të cilat për vitin 2015, janë 75% (Radoniqi) po ashtu 75% (Bifurkacioni), përderisa përqindjen më të ulët në këtë kategori e ka KRU "Hidroregjioni Jugor" me 55% e cila krahasuar me vitin 2014, ka pasur rënie prej 2% të këtyre shpenzimeve.

Kategorinë e dytë më të lartë të shpenzimeve e përbëjnë energjia, në mesataren e sektorit për vitin 2015, ato ishin 23% dhe janë më të larta se sa në vitin 2014 për 3%. Të shpenzimet e energjisë KRU 'Prishtina', prin me përqindjen më të lartë prej 29%, përderisa KRU "Radoniqi" shpenzimet e energjisë i ka vetëm 10% nga totali i shpenzimeve operative.

Performanca e NHE 'Iber Lepenci' sh. a. Prishtinë

ZRRUK është përgjegjës për rregullimin e pjesës së afarizmit të NHE 'Iber Lepenci' sh. a. Prishtinë cila ka të bëjë me furnizimin e ujit me shumicë për KRU Mitrovica' dhe KRU 'Prishtina' gjegjësisht për Nj. O 'Drenas'.

Në vazhdim po i japim disa të dhëna statistikore dhe disa tregues të performancës për të parë trendët e zhvillimit të performancës në vitin 2015 në raport me vitin 2014.

Tabela 10, Të dhënat statistikore për NHE 'Ibër-Lepenc' sh. a. Prishtinë

Të dhënat statistikore për 2015 / 2014	2014	2015
Vëllimi ujit me shumicë të faturuar (m3)	19,288,948	13,178,160
Faturimi për ujin me shumicë (€)	547,657	489,595
Arkëtimi për ujin me shumicë (€)	817,770	93,268
Kostoja e operimit për furnizimin e ujit me shumicë (€)	466,258	450,698
Numri i punëtorëve të angazhuar në furnizimin e ujit me shumicë	33	33

Në tabelën 11, është dhënë një pasqyrë të treguesve financiar në bazë të cilëve mund të vlerësohet performanca e NHE 'Iber Lepenci' gjatë vitit 2015 krahasuar me vitin 2014.

Tabela 11, Treguesit e Performancës së NHE 'Ibër-Lepenci'

Treguesi i performancës	2014	2015
Shkalla e arkëtimit	149%	19%
Norma e punës	1.17	1.09
Norma e mbulimit të punës	1.75	0.21
Kostoja e operimit për njësi (€/m3)	0.02	0.03

Shkalla e arkëtimit në vitin 2015 ka rënë në nivelin më të ulët si asnjëherë më parë dhe atë nga 149% në 19%, dhe kjo ka ndodhur si rezultat i mos arkëtimit të borxhit nga KRU "Mitrovica".

Përkundër rënies së shpenzimeve operative, kostoja për njësi është ngritur krahasuar me vitin paraprak e cila ngritje i dedikohet kryesisht rënies së vëllimit ujit me shumicë të faturuar (m3) për 32%.

5.4. INSPEKTIMI I OFRUESVE TË SHËRBIMEVE

Gjatë vitit kalendarik 2015, janë realizuar një numër inspekteimesht përfshirë:

- Faturimi (shpërndarja) në ndërtesat kolektive me ujëmatës të përbashkët dhe individual,
- Pastrimi i rrjetit dhe pusetave të kanalizimit,
- Procedurat interne për shqyrtimin e ankesave,
- Inspektimi i laboratorve kalibruar, në lidhje me vlersimin e kushteve të KRU, për testimin dhe kalibrimin e ujëmatesave.

Për këto aktivitete janë ndërmarr këto hapa: (i) përgatitjen e inspektimit (grumbullimin e informatave brenda ZRRUK dhe përgatitjen e formularëve të inspektimit), (ii) njoftimin e KRU-ve lidhur me arsyet dhe kohën e inspektimit, (iii) takimet me personat përgjegjës në KRU dhe grumbullimin e dokumenteve (dëshmime) të nevojshme, (iv) vizitat në terren - sipas nevojës, (v) përpilimi i Raportit të inspektimit me të gjetura dhe rekomandime, (vi) përcjellja e përmbushjes së rekomandimeve (përmes inspektimit - përpilimi raportit të përmbushjes së rekomandimeve).

Për zhvillimet më të hollësishëm për këtë aktivitet, mund të mësoni nga raporti i i Inspektore e cila është pjesë përbërëse e këtij raporti.

5.4.1. Shpërndarja e ngarkesave në ndërtesat e banimeve kolektive me ujëmatës të përbashkët

ZRRUK ka kërkuar nga të gjitha KRU-të e posaçërisht nga KRU “Prishtina” sh. a. Prishtinë ti mënjanojë të gjitha faturimet e pa-bazuara, duke u nisë nga fakti që në të kalueren ka pas raste të tilla, si dhe ti kompensojë të gjitha ata konsumatorë që kanë paguar ma tepër se sa realisht kanë marr shërbime nga kompanitë.

Pa rregulluesit e identifikuar gjatë vitit 2013 dhe 2014 ka ndodh te shpërndarja e ngarkesave përmes ujëmatësit të përbashkët për rastet kur në kuadër të ndërtesës, kryesisht kolektive ka edhe ujëmatës individual. Parregullsitë kanë konsistuar në faktin se sasia e ujit e cila i faturohet konsumatorit me ujëmatës individual nuk është zbritur nga sasia e ujit në ujëmatësin e përbashkët dhe i njëjti ujë është faturuar 2 herë (i është faturuar konsumatorëve me ujëmatës individual dhe i njëjti u është shpërndarë dhe faturuar edhe konsumatoreve tjerë të cilët faturohet përmes ujëmatësit të përbashkët).

ZRRUK i ka dhënë afat KRU “Prishtina” deri në Qershor 2015 për korrigjimin e të gjitha gabimeve të kësaj kategorie për konsumatorët në ndërtesat e banimit kolektiv. Ky proces është duke u monitoruar nga ZRRUK në vazhdimësi përmes inspektimeve.

5.4.2. Inspektimi për ngarkesën e konsumatorëve për dërgimin e njoftimit për shkyçje

Gjatë këtij viti kemi pasur numër shumë të vogël të këtyre kërkesave çka na bënë me kuptu se Ofruesit e Shërbimit kanë gjet mënyrë më efikase për arkëtimin e faturave.

Nga gjithsejtë prej 2 (dy) kërkesave për shkyçje, njëra kërkesë është zgjidhur me mos aprovim gjersa tjetra nuk ka mundur të finalizohet për shkak të mungesës së zyrtarëve kryesor të ZRRUK nga arsyet e cekura në hyrje të këtij Raporti.

Për këtë aktivitet janë ndërmarr këto hapa; (i) DL&L pranon kërkesën, (ii) procedimi i kërkesës Departamentit për Monitorimin e Performancës për shqyrtim, (iii) Mbajtja e Takimit të Komisionin për shqyrtim dhe vendimmarrje sipas kërkesave për shkyçje, (iv) Procedimi i Vendimit aplikuesit, etj.

Tabela. 12, Nr i shkyçjet kolektive gjatë vitit 2015

Nr. rend	Ofruesit e Shërbimeve/KRU	Aplikacioni	vendimi	Vërejtje
01	“Hidrodrini”Sh.A.Pejë	16.03.2015	Nuk Aprovohet	Zona rurale
02	“Bifurkacioni”Sh.A.Ferizaj	247	Aprovohet	Nuk është zyrtarizuar

5.5. STANDARDET E SHËRBIMEVE

ZRRUK, ka kërkuar nga ofruesit e ujit dhe kanalizimeve për të garantuar konsumatorëve të tyre një nivel të përcaktuar të shërbimit. "Standardet minimale janë shqyrtuar dhe miratuar nga ZRRUK dhe janë të obligueshme për tu përmbushur në të gjitha pikat e shërbimit të konsumatoreve nga ana O. SH. Ne i kemi inkurajuar konsumatorët se mund të përdorni këto garanci të niveleve minimale të standardeve të Shërbimit si bazë për adresimin e ankesave të tyre në raste të mos përmbushjes:

- **Sigurimi se KRU ofrojnë ujë cilësor**, ka qene njëri prej prioriteteve të ZRRUK-ut, i cili në vazhdimësi është adresuar si në mënyrë veçante por edhe në bashkëpunim me grupin ndërinstitucional për kualitetin e ujit. Në këtë kontekst janë realizuar aktivitete në vijim:
 - ✓ Realizimi i takimeve të vazhdueshme të drejtpërdrejta me KRU dhe IKSHP po edhe me KNMU
 - ✓ Raporti për shqyrtimin e dokumentacionit të dorëzuar nga KRU-të, lidhur me cilësinë e ujit të pijes dhe shkallën e përmbushjes së përgjegjësi të tyre sipas UA. nr. 16/2012”

- ✓ Letra qarkore për KRU dhe palët e interesit (NJPM-NP, IKSH, KNMU), datë 23.03.2015, Kualiteti dhe Monitorimi intern i ujit të pijshëm i ofruar nga KRU,
- ✓ Letrar qarkore për KRU dhe palët e interesit (IKSH, KNMU, QMU) datë: 11.11.2015 'Informimi në rastet e mospërputhjes(dështimit) të kualitetit të ujit.
- Takime të vazhdueshme në kuadër të grupit ndërinstitucional (ZRRUK, IKSH-QMU, KNMU, KRU), në lidhje me adresimi i përmbushja e përgjegjësi të dala nga UA 16/2012- për cilësinë e ujit për konsum nga Njeriu'
- ✓ Adresimi i monitorimit intern nga KRU për cilësinë e ujit,
- ✓ Akreditimi i laboratorëve për testimin e kualitetit të Ujit,
- ✓ Aprovimi i planeve operacinale të shtat KRU, për monitorimin intern të kualitetit të Ujit, etj
- **Saktësia e ujëmatësve** në baze të legjislacionit të ZRRUK, përkatësisht 'Rregulles Nr.03 U&K. për standardet e shërbimit', 'Ligji Nr. 04/L-121 për Mbrojtjen e Konsumatorit', si dhe 'Ligjit për Metrologji Nr.03/L-203', ofruesi i shërbimeve të ujit ka obligim ligjor të faturoj konsumatorët në bazë të konsumit të lexuar në ujëmatës të sakte, si dhe në mënyrë të ligjshme dhe transparent për shërbimet e ujit.
- Kemi kërkuar nga KRU, qe çështjen e ujëmatësve ta adresojnë në frymën e kontekstit ligjor dhe rregullativ që është i aplikueshëm në Kosovë sa i përket shërbimeve të furnizimit me ujë. Në këtë aspekt, korniza ligjore është mjaft konsistente, dhe në mënyrë të qartë përcakton kërkesën për matjen e ujit dhe saktësinë e faturimit që i ngarkohet konsumatorëve. Ne bashkëveprim me AMK-në, janë realizuar një numër aktivitete ne këtë drejtim:
 - ✓ Adresimi i shqetësimeve tek AMK si dhe akordimi për te ndërmarrë veprime te përbashkët me qëllim te adresimit te saktësisë se ujëmatësve,
 - ✓ Takime ne te gjitha KRU dhe inspektive ne Laboratorit ekzistuese për testimin e saktësisë se Ujëmatësve,
 - ✓ Përpilimi i Raportimit të përbashkët(ZRRUK-AMK) -"Mirëmbajtja e Ujëmatësve të Konsumatorëve nga Kompanitë Rajonale të Ujësjellësve në Kosovë me që rast kemi shpalosur të gjeturat dhe konkluzione dhe i kemi vendosur ne dispozicion të Institucioneve përgjegjëse dhe publikut,
 - ✓ Letrat qarkore tek të gjitha KRU-me kërkesën për sigurimin e saktësisë së ujëmatësve në përputhje me kërkesat aktuale logjiore,
 - ✓ Pjesëmarrja dhe diskutimi në tryezën e punës me rastin e ditës së meterologjis të organizuar nga AMK(MTI).

5.6. ROLI DHE AKTIVITETET E KOMISIONEVE KËSHILLUESE TË KONSUMATORËVE(KKK)

Është aktivitet permanent (mujo) i DL&L dhe i ZRRUK ku shqyrtohen ankesat, kërkesat, problemet dhe pakënaqësitë e konsumatorëve. Gjatë viti raportues janë mbajtur 78 (shtatëdhjetetë) Takime të Punës në 7 (shtatë) Regjione të Kosovës siç janë të organizuar (themeluar). Sipas raportit të KKK për vitin kalendarik 2015 e cila është pjesë e këtij Raporti, janë shqyrtuar 266 (dyqind e gjashtdhjet e gjashtë) ankesa/kërkesa dhe marrë Vendime të konsumatorëve, si dhe janë shqyrtuar aktiviteti si;

- i. informacioni dhe analizimi i procedurave për shqyrtimin e ankesave të konsumatorëve të Ofruesve të Shërbimit,
- ii. raporti lidhur me hulumtimin e opinionit të konsumatorëve për shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit në Kosovë,

- iii. informacionit lidhur me lidhjen e Kontratave të Shërbimit ,
- iv. Informacionit lidhur me leximin e ujëmatësve,
- v. raporti i përformancës ,
- vi. gjendja me furnizimin me ujë të konsumatorëve,
- vii. tarifat për ujë dhe kanalizim për vitet në vijim,
- viii. aktet nënligjore të ZRRUK-ut ,
- ix. çështjeve tjera të cilat janë në interes për konsumatorë,

Për këtë aktivitet janë ndërmarrë këto hapa si; (i) grumbulli i ankesave/kërkesave të konsumatorëve, (ii) konsultimi paraprak me ofruesin e shërbimit lidhur me rastin, (iii) procedimi i ftesave dhe i komunikatës për shtyp për mbajtjen e takimit, (iv) draftimi i vendimeve të mara nga takimi dhe procedimi i tyre ankuesve/kërkuesve, (v) dhënia e kontributit në aktivitete e shqyrtimit dhe amendamentimit, (vi) dalja në teren sipas vlerësimit etj.

Ajo që vlen të theksohet këtë vit janë përzgjedhja e kryesuesit e rinj të KKK, për të cilin aktivitet janë ndërmarr këto hap si; (i) procedimi i kërkesave kuvendeve komunale, (ii) pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave, (iii) pas zbatimit të procedurave të intervistimit përzgjedhja e kryesuesve të KKK, (iv) nxjerrja e vendimit sipas përzgjedhjes, (v) paisja me material-dokumente të nevojshme për punë, etj.

5.7. BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET TJERA

Bashkëpunimi i hapur i ZRRUK me të gjitha palët e interesit (si Kosovare ashtu edhe Ndërkombëtare) përmes koordinimit të aktiviteteve, shkëmbimit të informatave, përvojave etj, me qëllim të arritjes së rezultateve pozitive në sektorin e ujit ka qenë aktivitet i vazhdueshëm edhe gjatë vitit 2014.

a) Bashkëpunimi me Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK)

Në bazë të Memorandumit të Bashkëpunimit që kemi nënshkruar me IKSHPK në vitin 2007, edhe gjatë këtij viti ZRRUK ka vazhduar bashkëpunimin në fushën e monitorimit të përmbushjes së parametrave të cilët përcaktojnë standardet e kualitetit të ujit të pijes që ofrojnë kompanitë publike të licencuara.

b) Bashkëpunimi me Njësinë për Politika dhe Monitorim (NJPM) të MZHE

ZRRUK ka vazhduar bashkëpunimin me këtë subjekt në të cilat janë diskutuar problemet e shfaqura në operimin e ndërmarrje publike qendrore. Gjatë vitit 2015 kemi zhvilluar shumë takime të përbashkëta me qëllim të zhvillimit të sektorit.

c) Bashkëpunimi me Ministrinë për Integritet Evropian

Raportimet e rregullta për Planin e Veprimit të Partneritetit Evropian (PVPE), raportimi për Dialogun e Procesit të Stabilizim Asociimit (DPSA) dhe raportimi për Komisionin Ekzekutiv “Infrastruktura” është përmbushur nga ZRRUK sipas kërkesave të MIE.

d) Bashkëpunimi me përfaqësuesit e donatorëve (ZNKE, SDC, USAID, KFË, SCO, GTZ etj.) dhe konsulentëve që kanë qenë aktiv në sektorin e ujërave në Kosovë.

e) Bashkëpunimi me Zyrën e Këshillit Ndër-Ministror të Ujit (ZKNMU), e cila zyre funksionon në kuadër të Kryeministrit.

f) Bashkëpunimi me SHUKOS (Shoqata e Ujësjellës kanalizimeve të Kosovës) – përveç bashkëpunimit të rregullt të cilin e kemi me këtë Shoqatë, ZRRUK ka marrë pjesë me prezantime në punëtoritë e organizuara të kësaj Shoqate si në Kosovë ashtu edhe në punëtoritë dhe

seminaret të cilat kjo shoqatë I ka organizuar në bashkëpunim me SHUKALB (Shoqata e ujësjellës kanalizimeve të Shqipërisë)

- g) **Bashkëpunimi me Rregullatorin Ekonomik të Shërbimeve të Ujit të Shqipërisë (ERRU)**, bashkëpunim I rregullt i formalizuar me një Marrëveshje Bashkëpunimi në vitin 2009.
- h) **Bashkëpunimi shoqatën ndërkombëtare të ujit IWA** (anëtare e së cilës është edhe ZRRUK)
- i) **Bashkëpunimi me DANUBIS** (Programi i Benchmarkingut të Vendeve të Regjionit të Danubit), ZRRUK vazhdon të jetë pjesë e rrjetit ndërkombëtar për të dhëna operative, financiare dhe shërbimeve me konsumatorë, program ky i Bankës Botërore i njohur me emrin IBNET.

Me të gjitha palët (Kosovare dhe ato jashtë vendit) përmes takimeve të drejtpërdrejta, punëtorive dhe prezantimeve, ZRRUK ka dhënë kontribut duke paraqitur qëndrimin e vet lidhur me arritjet dhe ngecjet e sektorit. Bashkëpunimi me të gjitha palët gjithashtu na ka ndihmuar të informohemi me zhvillimin e sektorit dhe përvojat e vendeve tjera .

Nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit:

Pas takimeve dhe korrespondencës në vitet paraprake me qëllim të shkëmbimit të eksperiencave dhe adaptimit të praktikave më të mira, në vitin 2014 në takimin e mbajtur në Sofje/Bullgari me përfaqësuesit e Komisionit të Rregullatorit Shtetëror për Energji dhe Ujë të Sofjes (SEWRC) është nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit në mes dy Rregullatorëve.

5.8. RELACIONET ME PUBLIKUN

Gjatë vitit 2015 kurdo që është parë e nevojshme ZRRUK ka bashkëpunuar me mjetet e informimit publik, ka qenë dhe është i hapur për të vazhduar bashkëpunimin për çdo aspekt të shërbimeve publike të ujit. Mendojmë se opinioni është informuar për rolin dhe aktivitetet e Zyrës Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim në përgjithësi, përcaktimin e tarifave dhe ndikimin e tyre në ekonominë familjare etj.

Me qëllim të informimit të konsumatorëve, sensibilizimin e opinionit për rolin e KKK-ve, si dhe për të inkurajuar konsumatorët për pjesëmarrje në takime të KKK, ZRRUK përmes gazetave ditore çdo muaj ka publikuar dhe publikon Orarin e takimeve mujore të KKK në shtyp dhe në web-faqen e ZRRUK.

Përmes ueb faqes www.wwro-ks.org konsumatorët kanë mundësi të informohen detajshëm lidhur me të gjitha aktivitetet e ZRRUK.

6. REKOMANDIMET

Me qëllim të avancimit dhe përmirësimit të këtij sektori jetik për qytetarët, të gjitha institucionet përgjegjëse duhet të angazhohen maksimalisht në përputhje me përgjegjësitë e tyre institucionale dhe ligjore, ZRRUK rekomandon si në vijim:

- Përkrahja e mëtejshme institucionale të ZRRUK-it,
- Vazhdimin dhe bashkëpunim i mëtejshëm i palëve në sektor; Qeverisë, Kuvendeve Komunale, ZRRUK, IKSHPK, Kompanive Rajonale të Ujësjellësit dhe Donatorëve,
- Bordet Mbikëqyrëse në KRU, duhet të jenë profesionale, të pa anshme dhe të depolitizuara,
- IKSHPK të angazhohet në zbatueshmërinë e Udhëzimit administrativ Nr. 16/2012 për përmbushjen e standardeve të kualitetit të ujit,
- Qeveria të ndërmerr masat e duhura për Integrimin e Kompanive lokale në kuadër të Kompanive rajonale (në përputhje me Planin e Konsolidimit të ujit dhe Vendimit të Kryeministrit për integrimin e Njësive Operative në kuadër të KRU-ve),
- MMPH të angazhohet në sigurimin e lejeve për nxjerrjen e ujit dhe lejeve për shkarkimin e ujërave të zeza për KRU-të (të cilat janë edhe ndër kushtet e Licencës së kompanive), duke pasur parasysh se të gjitha KRU-të gjatë vitit 2015 do të aplikojnë për ripërtirjen e Licencave të shërbimit,
- Qeveria të sigurojë subvencionimin e faturave për shërbimet e ujit për konsumatorët të cilët janë në gjendje të rëndë sociale.

Aprovimi i këtyre rekomandimeve nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, si dhe zbatimi i tyre nga të gjitha palët do të ndikojë në ngritjen e nivelit të shërbimeve me ujë dhe kanalizim.

7. RAPORTI FINANCIAR

Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-086 (neni 8.4) ZRRUK financohet nga taksat vjetore të licencimit të ofruesve të shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit. Lartësia e taksave të licencimit caktohet në bazë vjetore sipas kritereve vijuese:

- Të hyrat nga këto taksa korrespondojnë me shpenzimet e planifikuara të ZRRUK për vitin aktual,
- Lartësia e taksës mos të tejkalojë 1.5% të qarkullimit bruto vjetor të ofruesve të shërbimeve.

Lartësia e Taksës vjetore të Licencimit për vitin 2015 ka qenë 1.28%

Buxheti vjetor i ZRRUK aprovohet nga Kuvendi i Kosovës. Me rastin e planifikimit të shpenzimeve vjetore ZRRUK udhëhiqet nga parimet e operimit eficient financiar me qëllim që rregullimi ekonomik i shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit të mos ketë kosto të lartë për konsumatorët.

Kostoja vjetore e Taksës Vjetore të Licencimit për vitin 2015 për një konsumator ka qenë 0.78 cent apo mujore 0.07 cent.

Shpenzimet e ZRRUK, Edhe pse të gjitha transaksionet financiare kryhen përmes barazimeve mujore të sistemit të Thesarit, ZRRUK mban kontabilitetin e vet financiar dhe material.

Për vitin fiskal 2015 ZRRUK ka pasur në dispozicion mjete financiare në lartësi 312,083.00 Euro.

Në tabelën më poshtë (Tabela nr. 12.) është dhënë pasqyra e mjeteve financiare të cilat kanë qenë në dispozicion të ZRRUK për vitin fiskal 2015 dhe shpenzimet e realizuara.

Tabela 13. Buxheti i ZRRUK për 2015

Kategoria e Shpenzimeve	Të buxhetuara (EUR)	Të realizuara (EUR)
Paga dhe Mëditje	181,086.00	177,792.00
Mallra dhe shërbime	124,495.00	109,849.00
Shpenzime Kapitale	-	-
Shërbimet Komunale/Publike	6,503.00	4,892.00
Total Buxheti	312,083.00	292,533.00

Buxheti i shpenzuar i vitit 2015 shprehur në përqindje është 93.74%

Formatin e Raportit të detajuar financiar të aprovuar nga Komisioni Parlamentar për Buxhet dhe Financa të Kuvendit të Republikës së Kosovës e keni të bashkangjitur (aneksi 1)

8. RAPORTIMI I ZYRËS SË AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Zyra e Auditorit të përgjithshëm ka audituar ZRRUK-un për periudhën 1 Janar -31 shtator 2015. Meqenëse akoma nuk e kemi pranuar Raportin e Auditimit për vitin 2015, po i paraqesim komentet dhe rekomandimet e Raportit të Auditimit për periudhën janar –shtator 2015 në bazë të të cilit edhe është përpiluar Plani i Veprimit sipas Rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm.

Për vitin 2015 kemi pasur tri(3) rekomandime me opinion të pakualifikuar. Rekomandimet e dala nga ky Raport janë përmbushur.

Rekomandimet nga Raporti i auditimit të ZAP janë paraqitur në tabelën në vijim.

Nr	Rekomandimet	Veprimi i menaxhmentit	Data e planifikuar e përfundimit	Personi përgjegjës
1	<u>Rekomandimi nr . 1</u> Ne dy raste blerjet janë bere pa procedura te prokurimit. Kjo është si pasoj e kontrollit te pa mjaftueshëm për aplikimin e procedurave te duhura te prokurimit	Kjo ka ndodhur rast emergjent blerja e një klime e cila është prishur dhe i ka shërbyer serverit, si pasoj e kësaj jane djegur dy hard diska te serverit dhe me rekomandimin e zyrtarit te TI-se kemi blere je aparat klime ne te kundërtën do te digjej i gjithë serveri.		Kryesuesi i Dep. të Adm. Dhe Financave
2	<u>Rekomandimi nr. 2</u> Për trajnimin me temën Procedurat disiplinore dhe Procedurat e Ankesave ne Shërbimin Civil. ZRRUK ka dërguar dy zyrtar ne Budva te Malit te Zi .Kostoja e trajnimit ishte 1,332€.ZRRUK pas CD vlerësimi vjetor te stafit duhet te përpiloj një plan te trajnimeve dhe ato qe kane te bëjnë me shërbimin civil te realizohen nga IKAP bazuar ne funksionin e tij.	ZRRUK ka hartuar planin e trajnimeve për vitin 2015 dhe e ka dorëzuar ne MAP-IKAP. Ky institucion asnjë trajnim nuk ka organizuar për vitin 2015 .Prandaj ZRRUK ka aprovuar trajnim për dy zyrtar ne temën e larte cekur		Drejtori i ZRRUK-ut
3	<u>Rekomandimi nr. 3</u> ZRRUK posedonte ne emër te tij pese vetura te cilat ende mbajnë targa civile. Sipas ZRRUK-ut është kërkuar nga Qendra e Regjistrimeve te Automjeteve qe regjistrimi te behet me targa zyrtare por nuk është aplikuar. Kjo çështje mbetet te trajtohet edhe ne fazën tjetre te auditivit.	ZRRUK ka bere kërkesë ne qendrën e Regjistrimit te veturave për ndërrimin e tabelave . Përgjigjja na ehte kthyer se nuk ka tabela. Ne kemi bere kërkesë edhe ne Kuvend qe te caktohen numrat për institucionin tone por ende nuk kemi marre përgjigje. Po sa ta marrin përgjigjen ne do te marrin edhe tabelat zyrtare.	Ne vazhdimësi te aktivitetit	Kryesuesi i Dep per Admin dhe Financa

Shtojca 1: Raporti Financiar për vitin 2015 sipas formatit të aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës

Adresa e ZRRUK

Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim

Rruga: Ferat Dragaj, Nr. 68

E-mail: info@wwro-ks.org

Web: www.wwro-ks.org